

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6091
E mërkurë, 19 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Viti akademik
universitar fillon
më 1 tetor në formë
virtuale dhe fizike



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ



MOCIONI I LV-së PËR QEVERINË, JOSERIOZ

Nënkryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, e ka cilësuar joserioze iniciativën e Lëvizjes Vetëvendosje për rrëzimin e qeverisë Hoti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai

ka thënë se përderisa kjo parti nuk i ka siguruar votat e mjaftueshme për rrëzimin e qeverisë, PDK-ja këtë mocion nuk e merr seriozisht. Ai ka thënë se tani nuk është momentumi për rrëzimin e

qeverisë dhe për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Totaj e ka mohuar mundësinë e hyrjes së PDK-së në këtë qeveri, duke thënë se kjo parti asnjëherë nuk e ka diskutuar këtë çështje në parti

KDI-ja: PUNA E KUVENDIT, PENG I BRISHTËSISË SË SHUMICËS PARLAMENTARE



Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se mbyllja e punimeve të sesionit pranveror nga Kuvendi, në kohën kur vendi ndodhet në mes të krizës ekonomike dhe asaj shëndetësore dhe disa projektligje që ndërlidhen me menaxhimin e pandeminë janë ende në procedurë, është e gabuar. Sipas tij, aktivitetet e Kuvendit gjatë këtij sesioni, veçanërisht gjatë periudhës mars-maj, ishin minimale, kurse performanca në ushtrimin e funksioneve ligjvënës, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese ka qenë e dobët

GJASHTË VIKTIMA DHE 141 RASTE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

NUK BËHET DREJTËSIA SI
DËSHIRON NJË SHKRUES
RAPORTESH (30) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

ARRIHET MARRËVESHJA
LSDM-BDI PËR QEVERINË
E RE, ZAEVI KANDIDAT
PËR KRYEMINISTËR F. 2

STOLTENBERGU: DIALOGU
NË BRUKSEL, MËNYRA
E VETME PËR ZGJIDHJE
TË QËNDRUESHME F. 6



EKONOMI

BIZNESET KËRKOJNË ZBATIM SA
MË TË SHPEJTË TË MASAVE TË
RIMËKËMBJES EKONOMIKE F. 9

ZEQIR KIQINA EMËROHET
USHTRUES DETYRE
I KRYESHEFIT EKZEKUTIV
NË TELEKOM F. 9

SPORT

ANULOHET NDESHJA
LINCOLN - PRISHTINA F. 16



Stoltenbergu: Dialogu në Bruksel, mënyra e vetme për zgjidhje të qëndrueshme

PRISHTINË, 18 GUSHT- Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se mirëpret përparimin në dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian "si mënyra e vetme për të arritur një zgjidhje politike të qëndrueshme".

Stoltenberg, përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", ka thënë se ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, për çështjen e dialogut dhe rëndësinë e misionit të NATO-s, KFOR-it,

për ruajtjen e sigurisë dhe luftimin e pandemisë së Covid-19 në Kosovë.

Ndërsa përmes një komunikate për media nga zyra e kryeministrit të Kosovës, thuhet se Hoti e ka vlerësuar punën e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), i cili po jep ndihmesë të rëndësishme për avancimin e institucioneve të sigurisë së Kosovës. "Sekretari Stoltenberg e siguroi kryeministrin Hoti se NATO-ja do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e Kosovës për të siguruar një

mjedis paqësor dhe një të ardhme të sigurt për të gjithë qytetarët e saj dhe të rajonit, si dhe mbështetjen për procesin e dialogut me Serbinë si mënyrë e vetme për të siguruar zgjidhje politike afatgjatë", thuhet në njoftimin nga zyra e kryeministrit Hoti.

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka rinisur më 16 korrik në Bruksel. Ky proces, që ndërmjetësohet nga pala evropiane, ka nisur më 2011. Ai ishte bllokuar nga nëntori i vitit 2018, pasi autoritetet e Kosovës patën vënë taksë në mallrat serbe.



Haradinaj-Stublla falënderon shqiptaro-amerikanët për aleancën Kosovë - ShBA



NJU JORK, 18 GUSHT (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, përpara se të niset në Uashington për takime me zyrtarë të Shtetit, të martën është takuar në Nju-Jork me biznesmenë e përfaqësues të tjerë të shqiptarëve të Amerikës.

Për kryediplomaten e Kosovës ishte nder i veçantë t'i takojë në Bronx të Nju-Jorkut

bashkërisht veprimtarët shqiptaro-amerikanë Hajdar (Harry) Bajraktari, Lisa Milicaj, Rustem Gecaj, dhe Man Celaj. "Ua përcolla të falat e përzemërta nga Kosova dhe falënderimin e thellë për kontributin e pashembullt dhe të vazhdueshëm të tyre në ruajtjen dhe kultivimin e lidhjeve të forta shqiptaro-amerikane", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla,

duke kujtuar edhe të kaluarën e tyre jo edhe aq të lehtë për të arritur aty ku janë dhe për t'i ndihmuar kauzës shqiptare. "Migruan në Amerikë në kohët më të vështira, ndihmuan afirmimin e çështjes së Kosovës atëherë kur ne nuk kishim zë, ndërsa sot gëzojnë reputacion të lartë në shoqërinë politike e të biznesit në ShBA, duke

mirëmbajtur me shumë përkushtim dhe vizion aleancat tona me Shtetet e Bashkuara", ka thënë shefja e diplomacisë së Kosovës.

Gjatë këtij takimi, ministrja Haradinaj Stublla takoi edhe anëtarin e Këshillit të Bashkisë së Nju Jorkut, Ritchie Torres, me të cilin bashkëbisedoi për zhvillimet historike dhe aktuale në Ballkan, si dhe për aspiratat politike e strategjike

të Republikës së Kosovës. "Kisha kënaqësinë që në këtë mes të takoj edhe Ritchie Torres, prej të cilit kërkoja që të mos e harrojë Kosovën, pavarësisht se ku do ta shpie e ardhmja e tij politike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka theksuar ministrja Haradinaj-Stublla, e cila nga këtu vizitën e saj të parë zyrtare në ShBA do ta vazhdojë në Uashington.

Arrihet marrëveshja LSDM-BDI për qeverinë e re, Zaevi kandidat për kryeministër

SHKUP, 18 GUSHT - Lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, pas takimit me liderin e BDI-së, Ali Ahmeti, ka bërë me dije se është arritur marrëveshja mes LSDM-së dhe BDI-së për qev-

erinë e re për katër vjetët e ardhshëm. Ai ka theksuar se ai do të jetë kryeministër i vetëm i vendit për katër vjetët e plota të qeverisë LSDM-BDI, duke lënë të nënkuptohet se



kryeministër shqiptar nuk do të ketë. Zaev ka pohuar se marrëveshja e arritur mes dy liderëve të martën do të duhet të kalojë edhe në kryesitë e dy partive. Ai ka theksuar se qev-

eria në periudhën e ardhshme do të fokusohet në sistemin shëndetësor duke i bërë ballë pandemisë Covid-19 dhe në reformat e kërkuara nga BE-ja.

KDI-ja: Puna e Kuvendit, peng i brishtësisë së shumicës parlamentare

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se mbyllja e punimeve të sesionit pranveror nga Kuvendi, në kohën kur vendi ndodhet në mes të krizës ekonomike dhe asaj shëndetësore dhe disa projektligje që ndërlidhen me menaxhimin e pandeminë janë ende në procedurë, është e gabuar. Sipas tij, aktivitetet e Kuvendit gjatë këtij sesioni, veçanërisht gjatë periudhës mars-maj, ishin minimale, kurse performanca në ushtrimin e funksioneve ligjvënëse, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese ka qenë e dobët

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 GUSHT- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën konferencë për media gjatë së cilës ka paraqitur të gjeturat nga monitorimi dhe vlerësimi i punës së Kuvendit të Kosovës në sesionin pranveror, të cilën e ka karakterizuar puna në kushte të emergjencës shëndetësore dhe krizës politike që ka pasuar. Eugen Cakolli nga KDI-ja ka deklaruar se mbyllja e punimeve të sesionit pranveror nga Kuvendi, në kohën kur vendi ndodhet në mes të krizës ekonomike dhe asaj shëndetësore dhe disa projektligje që ndërlidhen me menaxhimin e pandeminë janë ende në procedurë, është e gabuar. Sipas tij, aktivitetet e Kuvendit gjatë këtij sesioni, veçanërisht gjatë periudhës mars-maj, ishin minimale, kurse performanca për ushtrimin e funksioneve ligjvënëse, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese ka qenë e dobët. "Përveç problemeve me pandeminë, Kuvendi është ballafaquar edhe me kriza dhe përplasje politike të cilat kulmuan me votimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë 'Kurti' dhe votimin e qeverisë së re, të udhëhequr nga Avdullah Hoti. Gjatë periudhës së ndryshimit të qeverive, Kuvendi ka qenë tejte i limituar për ushtrimin e punës për shkak të pamundësisë për të ndërvepruar me një qeveri të shkarkuar, e në mungesë të një qeverie të re", ka thënë Cakolli. Ai ka shtuar se puna dhe aktivitetet e Kuvendit në përgjithësi, përveçse të pakta, ishin edhe peng i mungesës së konsensusit politik, përkatësisht të brishtësisë së shumicës së re parlamentare, e cila në shumë raste ka dështuar ta siguronte edhe shumicën minimale për votim në Kuvend. "Edhe pse pas

votimit të qeverisë 'Hoti', Kuvendi i ishte kthyer punës me kapacitete të plota, dinamika e punës kishte rënë ndjeshëm pas infektimit të disa deputetëve me koronavirus. Në këtë drejtim, Kuvendi, përkundër presionit publik dhe kërkesave të vazhdueshme, për shkak të mungesës së konsensusit politik, nuk kishte arritur t'i bënte ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e Punës, për ta mundësuar zhvillimin e punimeve në mënyrë elektronike", ka theksuar ai.

Sa i përket agjendës dhe mënyrës së zhvillimit të punës nga Kuvendi, Cakolli ka deklaruar që për shkak të pandemisë, ato kishin ndryshuar, meqenëse seancat plenare janë zhvilluar pa prani të mediave dhe shoqërisë civile, si dhe, me pajtim të grupeve parlamentare, në disa raste është shkurtuar edhe kohëzgjatja e diskutimeve. "Në anën tjetër, disa prej komisioneve parlamentare në disa raste aplikuan edhe metodën e mbajtjes së mbledhjeve në mënyrë virtuale", është shprehur ai. Mungesa e kuorumit në votim vazhdon të mbetet një prej sfidave kryesore të Kuvendit edhe gjatë kësaj legjislature. Sipas Cakollit, kjo problematikë është shpërfaqur më së shpeshti gjatë miratimit të pikave që kërkojnë konsensus më të gjerë politik, siç është ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. "Në mungesë të votave të 2/3 së deputetëve, pesë marrëveshje ndërkombëtare u ratifikuan vetëm pas tentativës së tretë dhe një muaj pasi ishin prezantuar para deputetëve në seancë" tha ai. Cakolli ka deklaruar që ky sesion është karakterizuar edhe me përdorim të shpeshtë të gjuhës dhe sjelljeve joparlamentare nga deputetët gjatë diskutimeve, duke



penguar kështu mbarëvajtjen e punimeve në seanca he në mbledhje të komisioneve, ku në dy raste kishte pasur ndërprerje të punimeve për shkak të situatave të krijuara. Sidoqoftë, puna e Kuvendit nuk ka kaluar pa zhvillime

pozitive. Sipas Cakollit, është vërejtur përmirësim në mënyrën e organizimit të punimeve plenare dhe mbledhjeve të kryesisë bazuar në Rregulloren e Punës, si dhe në numrin relativisht të madh të nismave ligjore të

deputetëve.

Ai ka pohuar, po ashtu, se zhvillime pozitive janë shënuar edhe në ruajtjen dhe shpenzimin më racional të parasë publike, pas vendimit të kryesisë për shkurtimin e shpenzimeve telefonike.

KDI-ja ofron të dhëna statistikore lidhur me punën dhe performancën e Kuvendit

- Janë mbajtur gjithsej 24 seanca, pesë prej të cilave nuk kanë arritur të përmbillen për shkak të mungesës së kuorumit për t'iu dhënë epilog edhe gjashtë pikave të mbetura nga këto seanca.

- Gjatë sesionit pranveror, komisionet parlamentare kanë realizuar gjithsej 145 mbledhje, prej të cilave 10 në mënyrë virtuale, si dhe është zhvilluar vetëm një dëgjim publik. Mbledhjet e mbajtura në mënyrë virtuale, kanë qenë të mbyllura për mediat dhe publikun, që ka pamundësuar monitorimin e agjendës dhe vendimmarrjes së tyre.

- Përveç punës së komisioneve funksionale, ky sesion është karakterizuar edhe me punën e komisioneve hetimore. Përgjatë kësaj periudhe janë formuar tri komisione hetimore parlamentare.

- Ndonëse Kuvendi nuk ka miratuar planin e punës, bazuar në planin legjislativ

të qeverisë dhe projektligjet e iniciuara nga vet deputetët, agjenda legjislative e Kuvendit përfshin gjithsej 138 projektligje. Gjatë sesionit pranveror, Kuvendi ka arritur që të miratojë vetëm 10 projektligje apo 7 për qind të numrit të përgjithshëm të projektligjeve të planifikuara.

- Sa i takon rolit mbikëqyrës, janë parashtruar gjithsej 71 pyetje parlamentare, prej të cilave 31 nga grupi parlamentar i LVV-së, pasuar nga PDK me 23 pyetje, AAK me 10 pyetje, LDK me 6 pyetje dhe 6+ me 1 pyetje.

- Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka mbajtur vetëm një interpelancë drejtuar kryeministrit Hoti e iniciuar nga grupi parlamentar i LV-së.

- Gjatë këtij sesioni, kanë dominuar debatet parlamentare, me gjithsej gjashtë të tilla, tri prej të cilave nuk janë përmblyllur për shkak të mungesës së

kuorumit për të votuar rezolutat apo rekomandimet e nxjerra nga ato debate.

- Sa i përket mbikëqyrjes nga komisionet parlamentare, nëntë prej 14 komisioneve parlamentare kanë ftuar për raportim gjithsej 23 herë ministrat e kabinetit qeveritar.

- Në këtë sesion, nuk është realizuar asnjë aktivitet në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, pavarësisht planifikimeve nga komisionet parlamentare.

- Dialogu Kosovë-Serbi, u diskutua në 11 prej seancave të mbajtura, ndërsa, si pikë e rendit të ditës, dialogu ishte në gjashtë prej tyre.

- Sa i përket transparencës financiare, për periudhën raportuese, Kuvendi ka miratuar dhe publikuar vetëm raportin financiar për tremujorin e parë të këtij viti. Në bazë të këtij raporti, deputetët kanë realizuar vetëm 16 udhëtime jashtë vendit me rreth 12 mijë euro shpenzime.



Flet për “Epokën e re”, Shaqir Totaj

Mocioni i LV-së për qeverinë, joserioz

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, e ka cilësuar joserioze iniciativën e Lëvizjes Vetëvendosje për rrëzimin e qeverisë Hoti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se përderisa kjo parti nuk i ka siguruar votat e mjaftueshme për rrëzimin e qeverisë, PDK-ja këtë mocion nuk e merr seriozisht. Ai ka thënë se tani nuk është momentum për rrëzimin e qeverisë dhe për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Totaj e ka mohuar mundësinë e hyrjes së PDK-së në këtë qeveri, duke thënë se kjo parti asnjëherë nuk e ka diskutuar këtë çështje në parti

formuar qeveria aktuale, PDK-ja ka deklaruar se do të jemi në opozitë, sikurse po themi edhe tani se do të qëndrojmë në opozitë. Kam dëgjuar nëpër media lloj-lloj informacionesh për këtë çështje, por unë ju siguroj se zyrtarisht në Kryesinë Qendrore të PDK-së nuk është diskutuar çështja e hyrjes së PDK-së në qeveri”, ka thënë Totaj.

“Epoka e re”: Z. Totaj, Lëvizja Vetëvendosje që disa ditë ka filluar procedurat për mocion të mosbesimit ndaj qeverisë. E ka shqyrtuar PDK-ja këtë çështje dhe cili është qëndrimi juaj përfundimtar?

Totaj: Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka qasjen serioze sa i përket kësaj pune. Ajo spekulon shumë dhe është jokonsekuente në qëndrime. PDK-ja as herën e parë kur është rrëzuar qeveria nuk ka dhënë nënshkrime për mocion dhe as kësaj radhe nuk do të japë. Nëse LV-ja e ka seriozisht

këtë çështje, le ta dëshmojë, t'i mbledhë votat dhe le ta sjellë mocionin në Kuvend dhe të na drejtohet në mënyrë formale dhe zyrtare për bashkëpunim, atëherë ne do ta shqyrtojmë seriozisht këtë çështje dhe do të vendosim.

“Epoka e re”: Pse e konsideroni joserioze iniciativën e LV-së?

Totaj: Derisa nuk i ka nënshkrimet dhe nuk arrin ta mbledhë numrin e mjaftueshëm të votave për mocion, e konsiderojmë iniciativë joserioze. Ndërsa neve nuk na është drejtuar në mënyrë formale e as zyrtare, ashtu siç do të duhej t'i drejtohej një parti partisë tjetër. Apelet në konferenca për media për ne janë joserioze.

“Epoka e re”: Ende s'ju është drejtuar zyrtarisht, për t'ju kërkuar nënshkrimet dhe votat për mocion?

Totaj: Jo, jo, ende.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka deklaruar se iniciativa e Lëvizjes Vetëvendosje për rrëzimin e qeverisë është joserioze. Ai ka thënë se qeveria nuk mund të rrëzohet pa i siguruar votat në Kuvend.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka

thënë se PDK-ja merret me këtë çështje vetëm pasi mocioni të vijë në Kuvend. “Derisa nuk i ka nënshkrimet dhe nuk arrin ta mbledhë numrin e mjaftueshëm të votave për mocion, ne e konsiderojmë iniciativë joserioze. Ndërsa neve nuk na është drejtuar në mënyrë formale e as zyrtare ashtu siç do të duhej t'i drejtohej një parti partisë tjetër. Apelet në konferenca për media për ne janë joserioze”, ka thënë Totaj.

Ai ka vlerësuar se tani nuk është koha e duhur për ta rrëzuar qeverinë. “Çështja e rrëzimit të qeverisë duhet të ndërlihet edhe me momentumin. Pra, të shihet se kur është momenti më i volitshëm për të shkuar në zgjedhje. Jo vetëm ta rrëzojmë qeverinë pa ditur çka më tutje”, është shprehur ai. Nënkryetari i PDK-së ka mohuar çdo mundësi që kjo parti të hyjë në qeverinë aktuale. “Edhe kur është

kritikon edhe PDK-ja. Cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të qeverisë?

Totaj: Për punën e kësaj qeverie ne nuk kemi qenë dhe nuk jemi optimistë. Pra, ne nuk kemi pasur ndonjë pritje nga kjo qeveri, sepse edhe kjo, sikurse ajo para saj, nuk do të sjellë ndonjë performancë të mirë. Ne kemi qenë skeptikë dhe për këtë arsye nuk jemi bërë pjesë e kësaj qeverie. Kemi qenë skeptikë sepse kjo qeveri është produkt i qeverisë së kaluar, e cila ka qenë totalisht e dështuar. Jo vetëm çështja e pandemisë, por edhe shumë gjëra të tjera nuk janë duke u menaxhuar si duhet. Qasja e kësaj qeverie ndaj pandemisë dhe masat të cilat po merren janë më tepër eksperimentale. Pra, këto masa nuk janë pasojë e ndonjë analize të mirëfilltë. Prandaj ne jemi shumë skeptikë për punën e kësaj qeverie. Besoj se zhvillimet e ardhshme do të tregojnë sesi do të procedojmë. Çështja e rrëzimit të qeverisë duhet të ndërlihet edhe me momentumin. Pra, të shihet se kur është momenti më i volitshëm për të shkuar në zgjedhje. Jo vetëm ta rrëzojmë qeverinë pa ditur çka më tutje.

“Epoka e re”: Mendoni se nuk është koha për rrëzimin e qeverisë?

Totaj: Konsiderojmë se tani

është koha e prioriteteve të tjera. E kemi pandeminë. Partia që ka iniciuar këtë mocion duhet ta dëshmojë se e ka seriozisht këtë çështje. Ta sjellë mocionin në Kuvend, të na drejtohet zyrtarisht, atëherë ne do ta shqyrtojmë këtë çështje dhe e shohim se si do t’ia bëjmë.

“Epoka e re”: Së fundi është folur për mundësinë e hyrjes së PDK-së në qeverinë aktuale. E keni diskutuar këtë çështje në kryesi të partisë?

Totaj: Pas përfundimit të zgjedhjeve të 6 tetorit të vitit të kaluar, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka deklaruar në mënyrë shumë korrekte se e pranojmë humbjen dhe do të jemi në opozitë. Neve elektorati na ka caktuar vendin në opozitë dhe do ta respektojmë verdiktin e elektoratit. Edhe kur është formuar qeveria aktuale PDK-ja ka deklaruar se do të jetë në opozitë, sikurse po themi edhe tani se do të qëndrojmë në opozitë. Kam dëgjuar nëpër media lloj-lloj informacionesh për këtë çështje, por unë ju siguroj se zyrtarisht në Kryesinë Qendrore të PDK-së nuk është diskutuar çështja e hyrjes së PDK-së në qeveri. Pra, nuk ka pasur diskutime zyrtare për këtë çështje.

“Epoka e re”: Ka pasur edhe individë brenda PDK-së që

kanë kërkuar përfshirjen e PDK-së në qeveri.

Totaj: Këto deklarime i kam parë si një tregues se PDK-ja jo vetëm që ka emrin Partia Demokratike, por është edhe parti e tillë, sepse askujt nuk i ndalohet të ketë një mendim tjetër, mirëpo vendimet merren në Kryesi të PDK-së dhe aty vendos shumica.

“Epoka e re”: A mund të presim që në të ardhmen të diskutohet kjo çështje apo PDK-ja nuk do të jetë pjesë e asnjë qeverie pa shkuar në zgjedhje?

Totaj: PDK-ja tani për tani nuk ka ambicie për të hyrë në qeveri. Natyrisht se ne jemi të përgatitur për zgjedhje. Në momentin kur të krijohen kushtet më të mira për zgjedhje, pra kur të kalojë pandemia, do ta themi mendimin tonë. PDK-ja është forcë politike relevante. Po shihet se proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, pa angazhimin serioz të PDK-së po shkojnë shumë më ngadalë. Natyrisht se ne kemi ambicie të hyjmë në qeveri pasi t’i fitojmë zgjedhjet, me kryeministër Kadri Veselin.

Epoka e re”: Kur mendoni se do të jetë koha e duhur për rrëzimin e qeverisë dhe mbajtja e zgjedhjeve të reja?

Totaj: Ka shumë mendime në

këtë drejtim. Personalisht mendoj se gjatë këtij viti nuk është momentum për rrëzimin e qeverisë. Në vitin e ardhshëm duhet të shohim se çfarë zhvillimesh do të kemi, se si është situata me pandeminë, pastaj të vendosim.

“Epoka e re”: Ju jeni edhe kryetar i Degës së PDK-së në Prizren. Si po ecën qeverisja e LV-së në këtë komunë?

Totaj: Kryetari Haskuka ka reaguar në mënyrë shumë arrogante duke shkarkuar disa drejtorë të shkollave që kanë qenë ushtrues detyre, ndërsa te disa drejtorë të shkollave të tjera ku ushtruesit e detyrës kanë qenë anëtarë të LV-së nuk janë shkarkuar. Konsiderojmë se këtu kemi mosrespektim të procedurave. Në njërin anë LV-ja ankohet se qeveria është shkarkuar në kohë të pandemisë, duke deklaruar se në kohë të pandemisë nuk duhet të merret me shkarkime, në anën tjetër këta vetë reagojnë në mënyrë shumë të vrazhdë, joligjore, duke i shkarkuar drejtorët. Aq më keq, atyre drejtorëve që ua kanë dërguar vendimet për shkarkim nuk ua kanë dërguar edhe kontratën se ku sistemohen pastaj ata, e cila është në kundërshtim me ligjin. Për këtë çështje shumë shpejt do të dalim në një konferencë për media.

“Epoka e re”: Përmes këtij mocioni po kërkohet rrëzimi i kësaj qeverisë, të cilën po e

Mbahet diskutim për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka organizuar të martën një takim, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të qeverisë, Ministrisë së Arsimit, drejtorët e DKA-ve, përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës, SBASHK-ut dhe Këshillit të Prindërve të Kosovës, në të cilin është diskutuar për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021 dhe për përgatitjet që janë bërë

për mbajtjen e Testit të Maturës. Me këtë rast, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Tahiri, ka theksuar se qeveria duhet të marrë një vendim i cili do të jetë ekzekutiv dhe për gjithë sektorin e arsimit, si dhe duhet të miratohet një masterplan për tri opsionet e propozuara, ndërsa në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike të vendosen parametrat për mbështetjen financiare të këtij sektori.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka falënderuar drejtorët e DKA-ve dhe të gjithë

aktorët e tjerë që kanë dhënë kontribut të madh për hartimin e një masterplani për fillimin e vitit të ri shkollor dhe të dokumenteve të tjera të rëndësishme për fillimin e procesit mësimor më 1 shtator.

Likaj ka theksuar se po bëhen të gjitha përgatitjet për t’iu përgjigjur tri opsioneve për fillimin e vitit shkollor, megjithatë ai ka kërkuar që vendimi përfundimtar të merret nga Qeveria e Kosovës, kërkesë e cila është përkratur edhe nga drejtorët e DKA-ve.

Ministri Likaj ka përmendur

koston e lartë në këtë drejtim, ndërsa ka theksuar se, përveç propozimit për buxhet për pako mbështetëse financiare nga qeveria, do të shikohen edhe mundësitë brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në mënyrë që të përkraten komunat. Po ashtu, ai ka theksuar se duhet të shikohen mundësitë për thjeshtësim të procedurave të prokurimit në mënyrë që të ketë përgjigje më të shpejtë konform situatës epidemiologjike.

Në këtë takim u vendos që të mbahet edhe një takim javën që

vjen dhe të merren vendime të përbashkëta në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor, të cilat më pas do t’i paraqiten Qeverisë së Kosovës për miratim. Gjatë takimit u diskutua edhe për organizimin e Testit të Maturës, për të cilin u tha se janë bërë të gjitha përgatitjet si nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, po ashtu edhe nga komunat, në mënyrë që testi të mbahet më 29 gusht 2020, duke i respektuar të gjitha rekomandimet e IKShP-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë për mbrojtje nga Covid-19.



Viti akademik universitar fillon më 1 tetor në formë virtuale dhe fizike

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 18 GUSHT- Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës ka shqyrtuar procesin e fillimit të vitit të ri akademik 2020/2021 në situatën e vazhdueshme të pandemisë Covid-19. Në këtë konferencë, në të cilën

kanë marrë pjesë shtatë rektorë të Universiteteve Publike, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi - kryesues, prof. dr. Alush Musaj - zëvendëskryesues, prof. dr. Marjan Demaj, prof. dr. Fadil Millaku, prof. dr. Agron Bajraktari, prof. ass. dr. Artan Nimani dhe prof. dr. Ismet Temaj, u theksua gatishmëria e të gjitha universiteteve publike të

Republikës së Kosovës që vitin akademik ta fillojnë në kohën ligjore, më 1 tetor 2020. "Për shkak të ruajtjes së shëndetit publik, viti akademik do të fillojë në formë të kombinuar: në formën virtuale dhe fizike. Ndërsa disa prej aktivitetëve të procesit mësimor do të vazhdojnë të bëhen në formën fizike, si provimi pranues për studentët e

rinj, provimet etj. Në të gjitha rastet universitetet publike do t'i respektojnë masat anti Covid-19. Ndërsa disa aktivitete të tjera, si ligjërata, konsultime, punime seminari etj., do të vazhdojnë në formatin online", është bërë me dije në njoftimin për media. Konferenca e Rektorëve në këtë mbledhje ka konstatuar se si rrjedhojë e shtyrjes së provimit të

maturës për 29 gusht 2020, studentët e vitit të parë do të pranohen me vonesë dhe mësimi për ta do të fillojë me vonesë deri në dy muaj. "Pavarësisht nga kjo, Konferenca e Rektorëve angazhohet që semestri për këta studentë të jetë i plotë dhe pa asnjë dëmtim të rrjedhës normale të procesit mësimor", theksohet në njoftimin për media.



Ahmeti: Komunat në bashkëpunim me institucionet qendrore të punojnë për rregullimin e shtretërve të lumenjve



PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se Kosova kohët e fundit shumë shpesh po përballet me vërshime, sidomos ato të shpejta. Ai ka bërë thirrje për masa të vazhdueshme preventive si dhe qasje serioze dhe afatgjatë institucionale. Ahmeti ka theksuar se komunat në bashkëpunim me

institucionet qendrore duhet të punojnë për rregullimin e shtretërve të lumenjve. "Mjaftojnë të reshura më të theksuara që zona të caktuara të përmyten. Duhet masa të vazhdueshme preventive si dhe qasje serioze dhe afatgjatë institucionale. Komunat në bashkëpunim me institucionet qendrore duhet të punojnë për rregullimin e shtretërve të lumenjve, kanaleve kulluese apo përroskave, në mënyrë që të pengohet dalja e ujit nga

shtretërit, që pastaj mund të shkaktojë vërshime, të ndalohej eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit mu në shtretërit e lumenjve, të ndalohet ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe urave në vendet që janë të rrezikuara nga vërshimet, të kontrollohen dhe ndalohen prerjet e pakontrolluara të pyjeve në afërsi të zonave vërshuese, në vendet urbane të përmirësohet infrastruktura nëntokësore (ujësjellësi, kanalizimi etj)", ka deklaruar Ahmeti.

Zyrtarët policorë dhurojnë gjak

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës, Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore, në bashkëpunim me QKK-TGJ, ka filluar aksionin për

dhurim vullnetar të gjakut i cili po realizohet në ambientet e Policisë së Kosovës. Në këtë situatë pandemie Policia e

Kosovës, edhe përkundër angazhimeve shtesë me detyra konkrete dhe me orare të zgjatura për parandalimin e përhapjes

së Covid-19, po vazhdon aktin human të dhurimit vullnetar të gjakut për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe atyre që kanë nevojë.



Gjashtë viktimat dhe 141 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë janë shënuar edhe 141 raste të reja me Covid-19. Megjithatë, janë shëruar nga ky virus edhe 219 persona të tjerë. Po ashtu, brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të vdekjes nga Covid-19

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar të martën se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar edhe gjashtë viktimat nga Covid-19. Në bazë të 494 mostrave të testuara, janë konfirmuar edhe 141 raste të të infektuarve, ndërsa sëmundjen Covid-19 e kanë mundur 219 pacientë. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i viktimave ka arritur në 416, i të infektuarve në 11 686, ndërsa janë shëruar gjithsej 7 562 persona. Edhe në 24 orët e fundit Komuna e Prishtinës i prin listës me numrin më të madh të infektuarve me Covid-19. Rastet e reja pozitive janë nga:

komuna Prishtinë 54 raste, komuna Gjilan 16 raste, komuna Mitrovicë 11 raste, komuna Ferizaj 10 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Podujevë 9 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Zubin Potok 2 raste dhe me nga një rast komunat Han i Elezit, Kamenicë, Kaçanik, Rahovec, Shtime, Skenderaj dhe Viti. Aktualisht në Kosovë raste aktive me sëmundjen Covid-19 janë 3 708 persona. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se në



institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 544 pacientë, prej tyre 439 janë të infektuar me koronavirus dhe po trajtohen në klinika dhe spitale. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se 19 pacientë janë në respiratorë, 22 janë duke u

trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 358 të tjerë janë me oksigjenoterapi. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën se ka licencuar edhe 16 laboratorë privatë për kryerjen e testeve për SARS COV 2. Kjo ministri ka njoftuar se tetë laboratorë janë

licencuar në Komunën e Prishtinës, ndërsa dy janë në Gjilan, dy në Ferizaj, një në Graçanicë, një në Lipjan, një në Vushtrri dhe një në Gjakovë. Deri më tani në Kosovë janë licencuar 69 laboratorë privatë për teste serologjike dhe virologjike për koronavirus.

Zemaj: Së shpejti do ta themelojmë Institutin për nënën dhe fëmijën



PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të martën Klinikën Gjinekologjike dhe atë të Neonatologjisë në QKUK, ku është njohur me gjendjen dhe punën që po bëhet në këto klinika si dhe me kërkesat e stafit mjekësor. Ai ka bërë me dije se së shpejti do ta themelojë Institutin për nënën dhe fëmijën. "Me qëllim të avancimit të shërbimeve shëndetësore, që motrat dhe nënat tona të marrin shërbime cilësore për nevojat e tyre, pa pasur nevojë të shkojnë për trajtime mjekësore jashtë vendit. Si ministër në mënyrë të veçantë e përkrah krijimin e familjeve të reja. Në mandatin

tim i kam dhënë prioritet të veçantë Klinikës Gjinekologjike dhe të Neonatologjisë në QKUK", ka thënë Zemaj. Ai ka thënë se qeveria e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti e mbështetë vazhdimin e përkrahjes për personelin shëndetësor me nga 300 euro edhe për muajt sa do të zgjasë pandemia. "Mjekët, infermieret dhe stafi mjekësor në tërë Kosovën janë heronjtë e sotëm. Unë si ministër dhe si Ministri e Shëndetësisë në përgjithësi gjithnjë do të qëndrojmë në krah të tyre. Do t'u ofrojmë për mbështetje të rezervë", ka thënë Zemaj.

ShKK-ja fillon lejimin e vizitave të lira, vizitave familjare dhe vizitave të avokatëve

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka njoftuar se nga 24 gushti, si masa lehtësuese mbrojtëse ndaj pandemisë Covid-19, do të fillojë lejimin e vizitave të lira, vizitave familjare dhe vizitave të avokatëve. "Shërbimi Korrektues i Kosovës nga kjo datë do ta fillojë lejimin e vizitave familjare për të burgosurit. Si masë lehtësuese për vizitë familjare do të fillojmë me pranimin e vetëm një (1) anëtarit të ngushtë të familjes.

Po ashtu, sipas procedurave, do të fillohet edhe me vizita të lira në lokale të veçanta. Nga kjo datë, ShKK do ta lejojë edhe vizitën e avokatëve vetëm me personat e paraburgosur. Gjatë vizitës së tyre avokatët janë të obliguar të kenë me vete ID kartelë valide" është bërë me dije në njoftimin e ShKK-së. Gjatë vizitës së tyre secili vizitor/avokat është i obliguar të dezinfektohet në hyrje të institucioneve korrektuese, po ashtu me vete duhet të

bartë edhe maskë mbrojtëse. "Shërbimi Korrektues i Kosovës ka filluar lehtësimin e masave në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve. Shërbimi Korrektues i Kosovës do ta vazhdojë bashkërendimin institucional me institucionet relevante të Republikës së Kosovës dhe do ta mbajë të informuar opinionin publik rreth hapave në vazhdim", është theksuar në këtë njoftim.



Zeqir Kiqina emërohet ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv në Telekom

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Bordi i Përkohshëm i Telekomit ka njoftuar se në mbledhjen e fundit ka miratuar kërkesën për dorëheqje të ushtruesit të detyrës së zyrta kryesor të Financave dhe Thesarit, Feim Kelmendi.

Sipas njoftimit, ushtruesja e detyrës e kryeshefes ekzekutive, Burbuqe Hana, ka bërë me dije se jep dorëheqje nga kjo pozitë. "Kërkesa e u. d. kryeshefes ekzekutive nuk ishte ligjore dhe, si e tillë, nuk mund të aprovohej nga Bordi. Në këtë formë dhe me këtë veprim Bordi është gjendur në një situatë të palakmueshme dhe të jashtëzakonshme. Ushtruesja e detyrës e kryeshefes ka qenë kategorike në dorëheqjen e saj duke mos pranuar kompromisin me Bordin e Përkohshëm. Andaj duke marrë për bazë faktin se proceduralisht dhe ligjërisht, bordi duhej të vendoste, të njëjtës ia miratoi dorëheqjen,

duke e liruar nga detyra të cilën e ka ushtruar nga 24 prilli", thuhet në njoftimin për media. Bordi i përkohshëm i Telekomit ka njoftuar se deri në publikimin e konkursit, ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv është caktuar Zeqir Kiqina. "Bordi ka vendosur përkohësisht zëvendësuesit në cilësinë e ushtruesve të detyrave deri në publikimin e konkursit. Ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv është caktuar Zeqir Kiqina, kurse ushtrues detyre i zyrta kryesor të Financave dhe Thesarit është caktuar Agim Matoshi", është bërë me dije në këtë njoftim.

Bordi në këtë njoftim ka theksuar se është siguruar që zyrtarët e vendosur si ushtrues të detyrës përkohësisht të jenë të pastër në aspektin ligjor dhe të njëjtët mund ta fillojnë punën vetëm nëse sjellin dëshmi nga gjykata se nuk janë apo kanë qenë në procedura hetimore.



"Bordi, po ashtu, ka vendosur që ta pezullojë matricën e autorizimeve e cila i jep kompetenca supreme kryeshefit

ekzekutiv dhe pikërisht nën mbështetjen e këtij akti ish-kryeshefat në vazhdimësi kishin nxjerrë vendime të dëmshme

për Telekomin duke e sjell në gjendjen që është", është thënë në njoftimin e Telekomit të Kosovës.

Familjet që janë refuzuar për pakon e asistencës sociale kanë afat deri më 31 gusht të bëjnë ankesë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka njoftuar familjet dhe qytetarët se nga data 17 gusht 2020 në të gjitha Qendrat për Punë Sociale pranë Komunave të Republikës së Kosovës ka filluar procesi njoftues dhe ankimor lidhur me vendimin për asistencën mujore, sipas masës nr. 15 të Pakos Emergjente Fiskale. "Të gjitha familjet të cilët kanë aplikuar për asistencë mujore në vlerë prej 130.00 eurosh, sipas masës nr. 15 të Pakos Emergjente Fiskale dhe të cilat deri me tani nuk kanë pranuar njoftim zyrtar përmes mesazheve telefonike apo kontaktimit të drejtpërdrejtë nga institucionet e nivelit qendror apo lokal, mund të paraqiten në Qendrat për Punë Sociale të komunës përkatëse, deri më 31 gusht 2020, për ta

pranuar vendimin zyrtar dhe për ta shfrytëzuar mundësinë e parashtrimit të ankesës kundër këtij vendimi", thuhet në njoftimin e MPMS-së.

Sipas këtij njoftimi, çdo familje që ka aplikuar për këtë masë do ta marrë vendimin së bashku me raportin e krahasimit të të gjeturave me sistemet elektronike të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) dhe krahasimin me Skemat Pensionale dhe Sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. "Ju njoftojmë, se çdo deklaram jo i saktë dhe dështim i prezantimit të dokumenteve apo fakteve reale gjatë procesit të parashtrimit të ankesave në Qendrat për Punë Sociale do ta pamundësojë procedimin e ankesës më tej në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave për



Masën nr. 15 në kuadër të MPMS-së. Për informacione apo sqarime shtesë lidhur me

procesin ankimor mund të kontaktoni në këta numra të telefonit: 038-212 311 dhe 038-

212 504", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministria e Ekonomisë është në përfundim të pagesave të Pakos Fiskale Emergjente



PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) është në përfundim të pagesave të Pakos Fiskale Emergjente (PFE): Masat, 3 A, 3 B, 7, 8 dhe 14. MEA ka njoftuar se brenda kësaj jave pritet për-

fundimi i pagesave për të gjitha këto masa. "Të gjitha ato biznese, apo individë që mbesin pa u paguar për shkak të gabimeve teknike në aplikim, do të paguhën pas filtrimit të llogarive nga sistemi i pagesave, në bazë të

PFE-së të personave apo bizneseve që janë pjesë e Pakos Fiskale. Ministria do të sigurojë të dhënat shtesë përmes kontaktit me bizneset në bazë të të dhënave të aplikimit në EDI-elektronik. MEA siguron se të gjithë për-

fituesit e përfshirë në këtë listë, pavarësisht prej gabimeve të mundshme, do të paguhën. Ky proces pritet të përfundojë në muajin shtator", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Bizneset kërkojnë zbatim sa më të shpejtë të masave të rimëkëmbjes ekonomike

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 GUSHT- Përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) kanë organizuar një konferencë virtuale me zëvendëskryeministrin Besnik Tahiri, në të cilën është diskutuar për të ardhmen e ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë për rimëkëmbjen nga pandemia Covid-19. Gjatë këtij diskutimi përfaqësuesit e bizneseve anëtare të Odës Amerikane patën mundësinë t'i shpalosnin shqetësimet e tyre dhe të ofronë rekomandime përkatëse për përkrahjen e nevojshme nga qeveria.

Zëvendëskryeministri Besnik Tahiri ka potencuar nivelin e dëmeve që pandemia Covid-19 ka shkaktuar mbi funksionimin e shtetit në përgjithësi si dhe ndikimin negativ mbi sferën e shëndetit publik dhe atë të ekonomisë. Sipas zëvendëskryeministrit Tahiri, problemi kryesor me të cilin janë ballafaquar deri më tani ka qenë sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për t'i mbyllur hendeqet e ndryshme dhe rënien drastike të të hyrave shtetërore. Ai ka shtuar se brenda strategjisë për rimëkëmbje ekonomike tanimë janë miratuar fonde specifike për qasje në

financa për të gjitha palët e goditura.

Tahiri ka thënë se vendimmarrja e qeverisë e cila lidhet me aktivitetet ekonomike, edhe pse në konsultim të ngushtë me sektorin privat, është mjaft e vështirë për shkak të nevojës së ruajtjes së shëndetit publik. Ai ka thënë se përmes Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike, me të cilin tashmë publiku është i familjarizuar, synohet të stimulohet qarkullimi i parasë në ekonominë e vendit duke disbursuar mjete edhe te sektori privat, por edhe te skema sociale. "Tani jemi në muajin gusht. Synimi ynë është që në këta dy muaj, në shtator dhe tetor, me kalimin e Ligjit për rimëkëmbje të ndihmojmë, sa më shpejt dhe në mënyrë sa më efikase, mbi bazën e parimeve dhe vendimeve që i kemi marrë, të bëjmë disbursimin e mjeteve te sektori privat dhe te skemat sociale", ka thënë zëvendëskryeministri Tahiri.

Kurse Erëmal Bajrami, menaxher i përgjithshëm në kompaninë "KFC", njëherësh kryesues i Komitetit të Gastronomisë dhe Turizmit të Odës Ekonomike Amerikane, ka folur për disa prej sfidave me të cilat po përballlet ky sektor. Sipas tij, industria e gastronomisë sfidën më të madhe e ka kufizimin e lëvizjes së qytetarëve deri në ora



22:30, gjithashtu ndalimin e shfrytëzimit të pishinave në hapësirat e jashtme, ndërsa lejohen ato në hapësirat e brendshme. Bajrami ka folur edhe për tatimin në vlerën e shtuar për këtë sektor, i cili në Kosovë është i njëjtë me TVSh-në për produkte apo shërbime të tjera e që, sipas tij, duhet të jetë më e ulët siç është në shtetet e tjera. Ai ka prezantuar edhe dokumentet e Komitetit të Gastronomisë dhe Turizmit

për përkrahjen për ndërmarrjet e këtij sektori i cili është një ndër më të goditurit në Kosovë. Kryesuesit e komiteteve dhe anëtarët e Odës Ekonomike Amerikane u shprehën se, pavarësisht që shumica e pakos së rimëkëmbjes është më modeste kundrejt asaj që është pritur, kërkohet që me urgjencë të nisë zbatimin e pakos së masave të rimëkëmbjes. Ata u bënë apel deputetëve të Kuvendit të Republikës së

Kosovës që me procedurë të shpejtë ta aprovojnë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike si dhe projektligjet e tjera të natyrës ekonomike. Përfaqësuesit e bizneseve u shprehën se në shumë sektorë situata aktuale është më e vështirë tash se pas vendosjes së masave kufizuese, pavarësisht lehtësimit të masave, dhe neglizhenca e deputetëve të Kuvendit po çon në depresion të thellë ekonomik.

INSTAT: Shqipëria ul eksportet me Kosovën 13.4 për qind, i rrit me Serbinë 42 për qind

TIRANË, 18 GUSHT- Më shumë mallra eksportoi dhe importoi Shqipëria në muajin korrik në raport me muajin qershor të këtij viti, ndërsa krahasuar me vitin 2019, tregtia vijon të jetë në rënie të ndjeshme. Vetëm në muajin e kaluar Shqipëria ka eksportuar mallra me vlerë 25 miliardë lekë dhe ka importuar nga jashtë 56 miliardë lekë mallra, duke përkeqësuar deficitin tregtar. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në muajin korrik deficiti tregtar arriti në 32 miliardë lekë ose 9.9 për qind më shumë se në qershor 2020. Si pasojë e pandemisë dhe mbylljes së shumë aktiviteteve prodhuese tregtia u shkurtua. Të dhënat flasin për një rënie të eksporteve në 7 muaj me 16.8 për qind dhe të importeve me -13.2 për qind. Në total deficiti tregtar që nga janari deri në

korrik arriti në 178 miliardë lekë.

Sektori duket se po e përjeton më rëndë situatën e krijuar nga Covid-19, pasi eksportet në shtatë muaj të grupit të tekstileve dhe këpucë ka rënë 8.8 për qind. Po nga janari-korrik vendi ka vendosur të eksportojë me pak materiale ndërtimi dhe minerale dhe energji elektrike, ndërsa rritje në eksporte ka pasur në grupin e ushqimeve dhe makinerive e pjesëve të këmbimit.

Nga ana tjetër, Shqipëria ka importuar 4.2 për qind më pak energji elektrike në 7 muajit e vitit. Përpos grupeve që kanë ndikuar në rritjen apo uljen e shkëmbimeve tregtare, kategoria e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike mban peshën më të madhe në tregti. Në 7-muaj vendi ka eksportuar 149.9 mil-



iardë lekë dhe ka importuar 327.773 miliardë lekë vetëm ushqime.

Vendet me të cilat kemi pasur më shumë tregti gjatë muajit korrik ishin Çekia, Serbia dhe

Rumania, ndërsa ka ulur tregtinë me Italinë, Kosovën dhe Spanjën.

Drejtori për Shëndetësi në Prishtinë viziton QKMF-në, takon personelin shëndetësor

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Drejtori për Shëndetësi, Bujar Gashi, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe personelin shëndetësor të cilët nga fillimi i pandemisë Covid-19 janë në vijën e parë të frontit duke u ballafaquar me këtë virus.

Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se situata epidemiologjike mbetet edhe më tutje e rënduar prandaj, sipas tij, është momenti i duhur që të fillohet implementimi i praktikës për caktimin e terminëve për vizita kontrolluese në Qendra të

Mjekësisë Familjare. "Kjo po bëhet me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në shërbime shëndetësore, si dhe që mjeku të ketë kohë të mjaftueshme ta ekzaminojë në mënyrë adekuate secilin pacient. Natyrisht, rastet urgjente do të trajtohen me përparësi pa caktuar termin. Duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, mirëpresim çdo ankesë, kritikë dhe sugjerim gjatë kësaj kohe dhe ju falënderojmë që të na ndihmoni që shërbimet cilësore t'i avancojmë në vazhdimësi. Vazhdoni t'i mbani maskat, pastroni duart e respektoni distancën fizike", ka shkruar Ahmeti.



Komuna e Malishevës ndan 42 motokultivatorë për bujqit



MALISHEVË, 18 GUSHT (ER) - Në kuadër të përkrahjes dhe subvencionimit në fushën e bujqësisë, Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, i ka shpërndarë 42 motokultivatorë për bujqit, të cilët kanë aplikuar në shpalljen e datës 03.07.2020, për përkrahje me mekanizëm bujqësor, përkatësisht motokultivator. Në fillimin e shpërndarjes së

motokultivatorëve për 42 bujq të Komunës së Malishevës ishin të pranishëm edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori për Bujqësi, Murat Hoxha. "Uroj t'i gëzoni dhe t'i shfrytëzoni sa më shumë dhe sa më mirë, të gjithë ju që këtë vit jeni përfutues të këtyre motokultivatorëve. Ky nuk do të jetë i vetmi subvencion apo e vetmja përkrahje, por ne do të vazhdojmë përkrahjen e sektorit të bujqësisë, pasi

bujqësia është prioritet për ne", ka thënë kryetari Begaj me rastin e shpërndarjes së motokultivatorëve.

Drejtori për Bujqësi, Murat Hoxha, ka bërë me dije se, krahas motokultivatorëve, drejtoria ka bërë shpallje edhe për subvencionim në serra si dhe për përkrahje të bletarëve lokalë, me qëllim që të ndihmohen dhe të përkrahen bujqit dhe fermerët e Komunës së Malishevës.

Në Ferizaj diskutohet për draftin e Kodit të etikës


FERIZAJ, 18 GUSHT (ER) - Në teatrin e qytetit në Ferizaj është diskutuar drafti i Kodit të Etikës për zyrtarët komunalë. Hapjen e këtij diskutimi e ka bërë kryesuesja e Kuvendit e Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyqi, e cila ka theksuar se ky Kod i Etikës është bërë në bashkëpunim edhe me zyrtarë të ministrisë, përderisa ka shtuar se ka rëndësi tepër të madhe për të gjitha institucionet.

Ndërkaq drejtoresha e Administratës së Përgjithshme, Aurora Ramadani-Abazi, është shprehur se ky kod ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat e sjelljes, veshjes si dhe masave ndëshkimore të shkëlqes eventuale nga zyrtarët e komunës dhe përfaqësuesit e asamblesë, sipas rregullave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të

komunës. Sipas drejtoreshës, kodi synon zhvillimin e kulturës organizative të punës brenda institucionit për të forcuar dhe promovuar parimet bazë të etikës që do të zbatohen nga zyrtarët e komunës. Vërejtjet dhe sugjerimet e zyrtarëve komunalë do të pranohen edhe brenda 16 ditëve të punës në mënyrë që Kodi i Etikës të jetë sa më i kompletuar.



Në Podujevë vazhdon të mbetet grumbullimi i njerëzve në kafiteri, dasma dhe varrime



PODUJEVË, 18 GUSHT (ER) - Në mbledhjen e Shtabit Emergjent të Komunës së Podujevës, të cilën e ka udhëhequr drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zaim Thaçi, është diskutuar rreth zbatimit të masave mbrojtëse ndaj Covid-19 dhe për gjendjen e përgjithshme epidemiologjike në Komunën e Podujevës.

Për statistikën aktuale dhe situatën epidemiologjike në Komunën e Podujevës, anëtarët e Shtabit Emergjent, i informoi epidemiologjia Bedrie Rama, e cila tha se situata me Covid-19 në

komunën tonë ditët e fundit ka një rënie të lehtë në numrin e të infektuarëve. "Mund të themi që kemi shenja të lehta pozitive drejt përmirësimit të gjendjes", ka thënë ajo.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë, Bekim Zogiani, ka thënë se ekipet policore janë vazhdimisht në terren, duke përcjell gjendjen rreth respektimit të masave dhe rekomandimeve nga IKShPK dhe MSh. Ai ka thënë se numri i fletëparaqitjeve secilën ditë është në rritje dhe Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar që të gjithë ata qytetarë apo biznese

të cilët nuk i respektojnë masat do të përballen me ligjin.

Sipas Shtabit Emergjent, shqetësuese vazhdon të mbetet grumbullimi i njerëzve në rastet siç janë: bizneset e fushës së gastronomisë që frekuentohen nga shumë qytetarë, dasmat, varrimet dhe pritjet e të pameve apo ngushëllimet.

Drejtori i Inspeksionit, Durim Salihu, tha se janë katër ekupe të inspektorëve në terren të cilat çdo ditë po përcjellin gjendjen dhe respektimin e masave dhe rekomandimeve të IKShPK-së dhe MSh-së.

NUK BËHET DREJTËSIA SI DËSHIRON NJË SHKRUES RAPORTESH (30)



Shkruan: Kudusi LAMA

Dhe megjithëse me gjuhë gjarpri, shkruasi detyrohet edhe këtu të deklarojë se kush ishin fitimtarët dhe kush ishin humbësit e luftës. Për këtë shprehet: “Nuk mund dhe nuk duhet të ekzistojë një drejtësi për fituesit dhe një tjetër drejtësi për të mundurit. Në çdo konflikt, tërë kriminelët duhet të ndiqen penalisht dhe të cilësohen përgjegjës për aktet e tyre të paligjshme, cilido qoftë kampi të cilit i përkasin dhe pavarësisht nga roli politik që kryejnë”. Plotësisht dakord jam edhe unë që çdo kriminelë pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare apo grupin luftarak të cilit i përket duhet të ndëshkohet me rreptësinë më të madhe të mundshme. Por gjithnjë përballë fakteve, jo përballë shpifjeve. Nuk bëhet drejtësia si dëshiron një shkruas raportesh, por si paraqitet gjendja e fakteve në terren. E terrenin përsëri kjo rezolutë e përcakton kështu: “Çështja më e mprehtë dhe më delikate, nga pikëpamja humanitare, është ajo që ka të bëjë me personat e zhdukur. Nga mbi 6 000 dosjet e personave të zhdukur të çelura nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, rreth 1 400 persona janë gjetur të gjallë dhe 2 500 kufoma janë arritur të zbulohen e të identifikohen. Është fjala në shumicën e tyre për viktime kosovare shqiptare të gjetura në varret masive të zbuluara në rajonet që janë nën kontroll serb dhe në Kosovë”. Si qenka e mundur të zbulohen të zhdukurit në Serbi e nga serbët, të cilët i kanë zhdukur dhe fshehur me organizim shtetëror, me mjete shtetërore, me polici e ushtri, me gjithë mundësitë për t'i dërguar sa më larg deri në Danub e për t'i gpropur sa më thellë. Ndërsa nuk arrihet të gjendet asgjë nga pretendimi për të zhdukurit nga UÇK-ja, që për të zhdukur një njeri do të duhej përdorur kazma e lopata se mjete të tjera nuk ka pasur. Do të duhej marrë në shpinë me barelë se as automjete për transport nuk ka pasur. Dhe megjithatë nuk gjendet asgjë, por shkruhet se megjithatë luftëtarët e UÇK-së janë kriminelë. Absurditet naiv.

Rezoluta që shoqëron këtë raport, e cila kuptohet, që siç shihet dhe e theksuam edhe më lartë, është përpiluar po nga e njëjta dorë, përmban elementë që unë pajtohem me ta, pasi duket se janë të drejta. Por në vazhdim tërheqin vëmendjen disa pika të saj, për të cilat nuk mund të

kalohet pa reagu.

Në pikën 2, duke pretenduar të vërtetohet të pa vërtetueshmen, duke iu referuar Karla Del Pontes, thotë: “... këto akte ishin kryer nga anëtarë të milicive të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” (UÇK) ndaj shtetasve serbë mbetur në vend në fund të konfliktit të armatosur dhe të cilët ishin zënë robër”. Unë pyes, gjithkënd që ka jetuar në atë kohë në Kosovë dhe në Shqipëri; a ka pasur baza të UÇK-së në Shqipëri pas datës 22 qershor, kur është konfirmuar largimi i ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova? Një përgjigje e tillë në këtë pyetje është përgjigja me e qartë për pavërtetësinë e pretendimit. Le të dalë dikush para meje dhe të thotë se ka pasur baza të UÇK-së në Shqipëri pas datës 22 qershor 1999. Sepse një gjë e tillë nuk ka ekzistuar. Ai terren ka qenë nën kontrollin tim se kam qenë komandant i asaj zone. Dhe kam qenë një komandant që vërtetë komandant.

Njëkohësisht, unë me cilësinë e komandantit të zonës, pas datës 13 qershor, kur kam përcjellë për në Kosovë forcat gjermane të KFOR-it, jam detyruar të ve të gjitha forcat ushtarake të divizionit me qendër në Kukës, që të kontrollojnë gjithë zonën prej bjeshkës së Kallabakut e deri në tre kufijtë me Malin e Zi, për të mbledhur armatim e municione, nëse kishin mbetur prej luftëtarëve në rrugët e kalimit të tyre për në front dhe në vendqëndrimet e tyre. Dhe së dyti, për të evidencuar edhe njëherë me saktësi rajonet e minuara në kufi prej forcave serbe gjatë luftës. Raportimi për zbatimin e këtyre detyrave më është bërë me datën 28 qershor 1999 nga personat përgjegjës. Si ka mundësi që efektivat e kuadrove oficerë dhe të ushtarëve të divizionit që drejtoja, megjithëse shkelën me këmbë çdo pëllëmbë vend, nuk u ballafaquan me asnjë pamje të tillë dhe duhet të zbulohen 12 vjet më vonë, prej dikujt që nuk di as se ku është ky rajon?

Pa folur që prej atij momenti në gjithë hapësirën e vijës kufitare kanë vepruar forca speciale xheniere dhe ekspert ndërkombëtarë për pastrimin e terrenit nga minat serbe, sepse u bënë shkak i qindra aksidenteve e vdekjeve të kalimtarëve luftëtarë në kohën e luftës apo të rastit pas përfundimit të luftës. Edhe ata megjithëse ishin vëzhgues të imtë të çdo vendi të strehimit, apo të rrugëkalimit nuk vërejtën asgjë të dyshimtë të këtyre pretendimeve. Në pikën 3, pretendohet se pasi janë mbledhur informata të shumta, (kuptohet në kuadër të hamendësimeve), është “gjetur” më në fund se “këto akte ishin kryer nga anëtarë të milicive të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” (UÇK) ndaj shtetasve serbë mbetur në vend në fund të konfliktit të armatosur dhe të cilët

ishin zënë robër”. Për këtë në radhë të parë duhet thënë se Policia Ushtarake e UÇK-së ka qenë në numër shumë e kufizuar dhe nuk ka pasur kohë të merret me gjëra të tilla, sepse kishte detyra mjaft të dendura me shoqërimin e kolonave që shkonin çdo ditë drejt frontit; me furnizimin materialo-teknik e me armatim municion të fronteve, që kishin nevoja të vijueshme, për faktin se furnizimi bëhej me kafshë, pasi rrugët i kontrollonte ushtria dhe policia serbe, ashtu edhe mjetet e transportit e magazinat i kishin ata. Pa folur që duhej shumë kujdes në kalimin e kufirit midis Shqipërisë e Kosovës sepse ushtria serbe kishte bërë minime masive në kufi, e për këtë ishte e fokusuar më së shumti policia ushtarake e UÇK-së. Se kur kanë pasur kohë tjetër ata që të merren me trajtime burgjesh, këtë nuk arrij ta kuptoj, megjithëse gjithnjë kam qenë në detyrë dhe mendoj se e kam kontrolluar mirë zonën time të përgjegjësisë, jo vetëm me informacione për edhe duke qenë vazhdimisht vetë në lëvizje, duke parë me sy, duke prekur me dorë e duke shkelur me këmbë çdo pëllëmbë vendi të zonës dhe të vijave të fronteve e të bazave të furnizimit dhe të trajnimit të luftëtarëve.

Ndërsa në pikën 4, thuhet: “... në periudhën menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur, para se forcat ndërkombëtare të merrnin me të vërtetë në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin njëfarë rendi e ligjshmërie, robërve të zënë duhet t'u jenë marrë organet në një klinikë të ndodhur në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t'u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi”. Ky deklaram mendoj se është plotësisht abuziv dhe mashtrues, pasi pas përfundimit të luftës, nga djemtë e vashat luftëtarë të UÇK-së nuk ka pasur asnjë në Shqipëri, pasi të gjithë vrapuan drejt vendit të tyre dhe u angazhuan për të kontribuar për stabilizimin e jetës në vend, pikërisht që të mos kishte asnjë problem me vendosjen e të kthyerve në vatrën e tyre, pasi të gjitha sakrificat për këtë ishin bërë. Së dyti, forcat ndërkombëtare sipas marrëveshjeve të nënshkruara me shtetin shqiptar është e vërtetë që kanë kaluar nëpër Shqipëri, por nuk kanë pasur asnjë detyrë e të drejtë të marrin në kontroll mbi territorin e Republikës së Shqipërisë. Shteti shqiptar do të ishte me shumë vend, për shprehje të tilla të kërkonte llogari prej autorit dhe Këshillit të Evropës që e ka pranuar këtë deklaram të papërgjegjshëm dhe denigruas për shtetin, pasi kuptohet me mendësi të tilla Evropa ka që në vitin 1992 që e zvarrit Shqipërinë në rrugën për anëtarësim, pasi duhen trajtuar shqiptarët në

mënyrën si trajtohen në këtë raport. Dhe jam i sigurt se Evropa meqenëse ka këto mendime për Shqipërinë as që ka për ta pranuar ndonjëherë ndoshta edhe për 30 vjet të ardhshme, megjithëse Shqipëria është i pari shtet i dalë nga diktatura në vitet '90, që ka bërë kërkesë për t'u anëtarësuar në vitin 1992.

Po kështu në pikën 5, bëhet një lidhje shumë e pa bazë, kur deklarohet: “Ky aktivitet kriminal, që u zhvillua duke përfutur nga kaosi që sundonte në rajon dhe me nismën e disa drejtuesve të milicive të UÇK-së të lidhur me krimin e organizuar, ka vazhduar, ndonëse në forma të tjera, gjer në ditët tona, siç e vërteton një hetim që po kryen Misioni i Bashkimit Evropian për Shtetin Juridik në Kosovë (EULEX) lidhur me klinikën “Medicus” në Prishtinë”. Nuk mund të pranohet se në Shqipëri dhe në Kosovë ka pasur kaos, që edhe dhe e zbuloi zotëri Marty. Askush nuk ka shkruar deri sot në këtë mënyrë. Dua të them se as gjatë luftës nuk ka pasur kaos, se po të ishte ashtu do të kishte ndodhur një e keqe e madhe kur ishin 1.5 milion njerëz të shpërngulur nga shtëpitë e tyre prej pushtuesit serb. Ky kaos mendoj se ekziston vetëm në kokën e zotëri Martyt, i cili me çdo mënyrë përpiqet të denigrojë jo vetëm njerëzit, por edhe gjithë hapësirën shqiptare.

Ndërsa për sa iu përket lidhjeve të luftës me klinikën “Medicus” në Prishtinë, nuk e kuptoj se si mund të krijohet një lidhje e tillë. Ajo klinikë ka qenë legale, e kanë ditur të gjithë, nëse ka bërë punë të paligjshme le të jepet llogari prej të gjithë atyre që kanë lidhje interesash me të, por të mendohet e të deklarohen lidhje të saj me periudhën e Luftës Çlirimtare më duket një dashakeqësi e pararendur prej hartuesit të raportit.

Njëkohësisht vërej se zotëri Marty në deklaramen që ka paraqitur sipas raportit të tij në emër të Këshillit të Evropës, e ka bërë të vërtetë, që disa prej drejtuesve të milicive të UÇK-së janë të lidhur me krimin e organizuar, sikur të hante bukë me djathë - themi ne shqiptarët. Po pse more zotëri bëni deklaramen që zakonisht bëhen pasi të marrë vendim gjykata? Ju nuk besoj se jeni edhe politikan, edhe hetues, edhe prokuror, edhe gjykatës; besoj se ju kishit për detyrë të bënit një hetim politik, por pa fuqinë e prokurorit e të gjykatës.

Le të lexojmë pikën 8, të kësaj deklarate: “GJPNJ, që kish nisur të bënte një shqyrtim të parë në vend për të zbuluar praninë e gjurmëve të një trafiku të mundshëm organesh, i braktisi hetimet. Elementët e provës të zbuluara në Rripe të Shqipërisë janë shkatërruar dhe rrjedhimisht, nuk mund të shfrytëzohen për analiza të mëtejshme. Kështu, asnjë hetimi nuk i është shkruar më tej për një çështje të konsideruar megjithatë

aq serioze sa ish Kryeprokuroerja e GJPNJ-së e pa të arsyeshme të bënte publike në librin e saj”. Pse zotëri bëheni kaq qesharak, kur bëni një deklaramen të tillë? Kryeprokuroerja e Gjykatës së Hagës Karla Del Ponte ishte aq e fuqishme, sa kur ishte çështja e mbrojtjes së serbëve dhe Serbisë mori Sllobodan Millosheviqin dhe e burgosi në Hagë, si ka mundësi që paska dështuar para një shtëpie fshatari? Kush të beson? Si mund të dështonte Karla Del Ponte, si mund të tërhiqej ajo, si mund të mos bënte të paktën një deklaramen sa ishte në detyrë? Jo zotëri, askush nuk i ha këto kumbulla të tuat se i mpihen dhëmbët. Detyra për të bërë këtë që po bëni u mor me vonesë, pasi ishin kaluar disa faza, pasi siç dukej Serbia mendonte se pas dorëzimit të Millosheviqit do të konsiderohej e larë, por kur kuptoi se duhej dhënë llogari se shqiptarët do të kërkonin gjithçka që u takonte, u thirr nga padronët serb Del Ponte. E meqë ajo ishte në fund të mandatit, u përgatit shpejt e shpejt libri i famshëm i saj, kurse në fushën institucionale misioni i shëmtuar kaloi tek ju, që të shfrytëzonit dritaren e Këshillit të Evropës, siç po e shfrytëzoni.

Në pikën 9 të deklaramen jeni shprehur se: “Gjatë fazës shpërndarë të konfliktit të armatosur, NATO-ja ndërhyri me anë goditjesh ajrore, ndërkohë që operacionet tokësore drejtoheshin nga UÇK-ja, aleate faktike e forcave ndërkombëtare. Pas largimit të autoriteteve serbe, aktorët ndërkombëtarë të ngarkuar me sigurinë në Kosovë u mbështetën gjerësisht tek forcat politike në pushtet në Kosovë, të dala kryesisht nga kuadro të UÇK-së”. Me gjithë tendencën tuaj në formulimin e kësaj pike, vlerësoj se kur shpreheni që “NATO-ja ndërhyri me anë goditjesh ajrore, ndërkohë që operacionet tokësore drejtoheshin nga UÇK-ja, aleate faktike e forcave ndërkombëtare”, keni të drejtë. Është e vërtetë që operacionet tokësore ishin përgjegjësi e UÇK-së sepse për këtë qëllim i kishin rrëmbyer armët ata djem e vasha të Kosovës. Prandaj nuk kishin si të mos ishte UÇK-ja aleatja reale e NATO-s. Por kur thoni se “aktorët ndërkombëtarë të ngarkuar me sigurinë në Kosovë u mbështetën gjerësisht tek forcat politike në pushtet në Kosovë, të dala kryesisht nga kuadro të UÇK-së”, mendoj se e keni gabim. Pikërisht këtu qëndron edhe fakti që ju arrini sot të na bëni portretin që përpiqeni të na bëni, sepse aktorët ndërkombëtarë në Kosovë nuk u mbështetën tek potencialet politike dhe ushtarake të dalë nga Lufta Çlirimtare e Kosovës. Po ta kishin bërë këtë nuk do të kishin dështuar në udhëheqjen e Kosovës në këtë periudhë kalimtare. Po ta kishin bërë këtë do të kishin dalë fitimtar ashtu siç doli NATO-ja me operacionet e saj ajrore, kur kishte UÇK-në si ushtri tokësore. (Vijon)

Shtypi gjerman vlerëson lart filmin “Exil” të Visar Morinës

Filmi “Exil” i Visar Morinës, regjisorit shqiptar nga Kosova që jeton në Gjermani, këto ditë është temë e shumë shkrimeve në shtypin gjerman. Për të është shkruar edhe më parë në superlativ, por publicitet më i madh po i jepet në veçanti tani për faktin se filmi do të fillojë të shfaqet më 20 gusht në rrjetin e kinemave të Gjermanisë.

Regjisorin Visar Morina është i njohur për publikun gjerman dhe atë ndërkombëtar edhe me filmin e tij të suksesshëm “Babai”.

Në vazhdim pjesë nga shkrimet e mediave të ndryshme gjermane, (si Kultur.de; pointer.de etj.) në lidhje me subjektin e filmit “Exil”.

Xhaferi është një inxhinier farmaceutik 45 vjeç, i cili ka lindur në Kosovë dhe tani jeton në Gjermani. Ai është i martuar me gjermanen Nora (Sandra Hüller) dhe kanë bashkë tre fëmijë, transmeton albinfo.ch. Filmi na tregon jetën e tij të përditshme, e cila merr një kthesë për të keq në momentin kur ai gjen një mi të ngordhur në portën e tij.

Ky gjest për të është fare qartë, me motiv racist. Kështu, ai fillon

të shohë racizmin prapa të gjitha problemeve të tij dhe gradualisht, me sjelljen e tij paranojake, largon familjen dhe miqtë. A është i arsyeshëm shqetësimi i tij? Apo ndoshta është vetë fajtor për situatën që po kalon?

E gjitha është një udhëtim i errët në mendjen e një njeriu që ndjen se po trajtohet padrejtësisht nga bota që e rrethon. Me këtë rast regjisorin Visar Morina dhe ekipi i tij arrijnë të empatizojnë audiencën me këtë njeri.

Rolin e Xhaferit e luan aktori i njohur gjerman me prejardhje kroate, Mišel Maticević. Ai këtu ka detyrën që dashamirësisht mesatarë të kinemasë t'i bëjë të kuptojnë një njeri në një situatë në të cilën ata vetë kurrë nuk do të jenë ... Dhe, Maticević e menaxhon shumë mirë këtë, përcjell albinfo.ch. Ai krijon një realitet të perceptuar të një njeriu delirant, të cilin e kemi të vështirë ta kuptojmë. Gruaja e tij Nora është në një mënyrë në të njëjtën situatë sikur shikuesi.

“Exil” është një projekt ambicioz që adreson në një mënyrë jo konvencionale çështje serioze si racizmi dhe ngacmimi



(mobingu). Dilema e ngatërruar në mes të racizmit të vërtetë dhe paranojës e përshkon në fakt gjithë filmin. Dhe duket se vetë regjisorin Morina e njeh më së miri këtë fushë: përvojat e tij personale me racizmin që përjetohet në përditshmëri gërshetohen në këtë film, transmeton albinfo.ch. Ai tregon sesi racizmi dhe paranoja shkojnë krah për krah dhe

ushqejnë njeri-tjetrin. Megjithatë, filmit duhet t'i bëhet një vërejtje për faktin se duke qenë në thelb një histori rreth racizmit, bëhet histori që rrezikon të relativizohet. “Exil” nuk është një film për të ndërë kënaqësi kur ta shikosh. Ai është më shumë një përvojë kërkuese që mund ta bëjë shikuesin të ndihet pakëndshëm. Por kjo është arsyeja pse padyshim ia

vlen të shikohet në kinema.

Filmi është bashkëprodhim në mes të Gjermanisë, Kosovës dhe Belgjikës: Titulli origjinal: “Exil”; Drama; D, Bel, RKS 2020; Regjisorin: Visar Morina; Skenarin: Visar Morina; Aktorët: Mišel Maticević, Sandra Hüller, Rainer Bock, Thomas Mraz, Flonja Kodheli; distribucioni: Alamode Film. Shfaqja në kinema fillon më 20 gusht 2020. /Albinfo.ch/

Mata Hari – kurtizane, valltare, spiune apo kundërshtuese e botës së sunduar nga burrat?

Në vitin 1999, Arkivi Kombëtar Britanik, pas 100 viteve ua hoqi embargon dokumenteve të Shërbimit Sekret Britanik që kanë të bëjnë me Margaretha Zelle-n. Kjo ishte gruaja që bota ndryshe e njihje si Mata Hari e më shumë si valltare, kurtizane dhe spiune.

Dokumentet arkivore britanike kanë bërë me dije se Mata Hari dyshohej nga shumë shërbime sekrete evropiane për spiunim gjatë Luftës së Parë Botërore. Shërbimi Sekret Britanik dy herë e kishte marrë në pyetje, por asnjëherë nuk gjeti asgjë inkriminuese. Ekzistonin fakte se Mata Hari kishte marrë para nga gjermanët, por kurrë nuk kishte vepruar sipas ‘pazarit’.


Në fillim të vitit 1917, një gjykatë në Paris, e përbërë kryesisht nga ushtarakët, e shpalli fajtoresh Mata Harin në tetë akuzat që iu kishin ngritur. Në fakt, asnjë nga akuzat nuk e dëshmuuan fajësinë, por ajo u dënua me vdekje. Hulumtuesit e kësaj teme bëjnë me dije se Mata Hari do të mund të dënohej për amoralitetet apo për gjithçka, por jo për spiunim se nuk kishte fakte.

Kjo është tema e romanit të Paulo Coelho-s me titull: “The Sp” (Spiunia). Coelho e fillon rrëfimin e romanit nga momenti kur Mata Hari, së bashku me disa gra tjera, nxirret nga burgu dhe ekzekutohen nga një njësi ushtarake për pushkatime. Në formë të një letre të saj, Coelho e vënë lexuesin në binarë të udhëtimit nëpër këtë roman, i cili, sikur edhe veprat tjera të tij, lexohen me një frymë.

Coelho i ka shfrytëzuar të dhënat e arkivit britanik për të krijuar tregimin të cilin e rrëfen me gojën e Mata Harit. Thënë ndryshe, shkrimtari këtu është vetë personazhi (Mata Hari).

Coelho vërtetë është i mahnitshëm. Janë të paktë shkrimtarët që kanë ndikuar në mënyrë pozitive të lexuesit në këtë botë sikur Coelho. Askush nuk e afron njerëzimin mes veti më shumë se ky shkrimtar. Te Coelho nuk ekziston dallimi në mes kombeve, ngjyrave dhe religjioneve të njeriut, rajoneve, kontinenteve... Ekziston vetëm e keqja dhe e mira apo abuzuesi dhe viktimja.

Mata Hari, e cila është akuzuar si



grua e pamoralshme me profesionin e saj të valltares dhe kurtizanes, akuzohet edhe për spiune. Në fakt, Mata Hari në këtë roman është viktimë e sistemit të vlerave të atëhershme – viktimë e mashkujve. Ajo dhunohet kur ishte vajzë e mitur nga drejtori i shkollës dhe kjo gjë, pasi që më nuk ishte e virgjër, e detyron të martohet me një

oficer që ishte së paku një herë më i moshuar se ajo. Burri e keqtrajton vazhdimisht, derisa ajo vendos të largohet nga ai dhe ta jetojë jetën e saj, duke i shfrytëzuar përparësitë e burrave, që i solli famë botërore. Pastaj u bë dashnore e një numri të madh të njerëzve të fuqishëm me pushtet dhe me para. Coelho na tregon se Mata Hari, duke u

viktimizuar, ishte partizane e çlirimit të gruas që filloi me ardhjen e shekullit XX. Por, burrat ishin ata që e akuzuan dhe e dënuan. Ajo qëndroi stoike edhe para vdekjes të cilën nuk e meritoi ashtu siç i ndodhi. Jeta dhe vdekja e Mata Harit në këtë roman është protestë e gruas kundër shoqërisë mujshare mashkullore. /Telegrafi/





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

‘Dritaret e verës’ të cilat ishin përdorur në Toskanë gjatë kohës së murtajës, rikthehen edhe sot mes pandemisë

Restorantet dhe baret në Itali kanë filluar rihapjen e ‘dritareve të verës’ si masë për respektimin e distancimit shoqëror, të cilat janë përdorur shumë vite më parë në kohën e murtajës. Sipas mediave të huaja, rreth 300 dritare të vogla gjenden në rajonin verior të Italisë të Toskanës, ndërsa 150 prej tyre janë gjetur brenda mureve të qytetit të vjetër të Firencës.



BARSOLETA E DITËS



Një çift po dilte në qytet. Rrugë e gjatë, nxehtë i madh, para tyre ndodhet një pemë dhe ata bashkë vendosin që të ulen nën të. Pas një kohe gruaja çon kryet lart me pa, kur sheh dy zogj sqep më sqep dhe i thotë të shoqit:
 - More burrë, ç’janë ka bajnë ata zogj atje nalt?
 - Janë ka puthen.
 - Po pse nuk më puth edhe ti mu?
 - Po kush drejtin ngjitet atje nalt!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje




FOTO E DITES



Pamje e shkrepur nga lart në plazhin e ‘Gjeneralit’ në Shqipëri

E rrallë

Paraziti i tmerrshëm ha gjuhën e peshkut dhe jeton në gojën e tij

Fotografitë e një paraziti të etur për gjak që jeton në gojën e një peshku, që gllabëronte gjuhën e tij, kanë dalë në internet. Postuar në mediat sociale nga një shkencëtar amerikan këtë javë, skanimet me reze X tregojnë një parazit, i njohur gjithashtu si një parazit që ha gjuhë, kanë pushtuar faqet e internetit këtë javë, shkruan “The Sun”. Paraziti “vampir” me gjatësi 4 cm pushton mikpritësin e saj nëpër gushë dhe bashkohet në pjesën e brendshme të gojës duke përdorur kthetrat e veta të forta.

 <p>DASHI Po ju sos durimi kundrejt personave të pavendosur. Ka gjasa që të acaroheni. Bëni kujdes me komunikimin. Mendohuni dy herë para se të veproni.</p>	 <p>DEMI Keni arritur në një pikë kritike me dikë për të cilin keni interes. Ju e dini sesi ndiheni, ndaj rekomandohet që të flisni hapur lidhur me këtë.</p>	 <p>BINJAKËT Një diskutim interesant sot mund t’ju frymëzojë për të ecur përpara me një projekt të ri. Kjo do t’ju falë kënaqësi dhe ta rrisni besimin në vetvete.</p>	 <p>GAFORRJA Dikush që bën shumë aventura në jetë mund t’ju duket interesant, por nuk ka thelbin që ju nevojitet aktualisht në jetën tuaj.</p>	 <p>LUANI Duhet të mendoheni më shumë në lidhje me çështje të caktuara si në jetën personale, po ashtu edhe në atë profesionale.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Bëni më të mirën e mundshme për të qenë i qetë, nëse përballeni me dramë. Nuk i detyroheni asgjë, përveçse vetes suaj.</p>
 <p>PESHORJA Një mik nuk po ju thotë të vërtetën lidhur me atë çfarë po bën. Ndoshta kjo vjen për shkak të frikës se mund të ndryshoni mendim lidhur me të.</p>	 <p>AKREPI Duke e kaluar të gjithë kohën e lirë me një person, po rrezikoni. Nuk mund t’i shpërfillni të gjitha marrëdhëniet e tjera në jetë.</p>	 <p>SHIGJETARI Bëni kujdes kur përballeni me të tjerët. Ata mund të mos kenë prioritetet e njëjta. Ndaj përgatituni për ndërprerje dhe debate të ndryshme.</p>	 <p>BRICJAPI Të afroresh më shumë me personat që i vlerësoni vërtet do të jetë më lehtë se asnjëherë. Kjo harmoni do t’jua bëjë jetën edhe më të këndshme.</p>	 <p>UJORI Do të jetë një ditë e qetë në përgjithësi. Nëse dikush ju shtyn drejt një veprimi të caktuar tani, është në interesin tuaj më të mirë që të rezistoni.</p>	 <p>PESHQIT Mund të ndiheni të shqetësuar dhe ka mundësi që kjo ndjesi të mos ju kalojë shumë shpejt. Ndoshta kjo mund të vijë për shkak se keni qenë shumë i ngarkuar.</p>

Oriola Marashi mahnit në imazhet e reja derisa pozon gjysmë e zhveshur



Ajo rrëmben vëmendje të madhe sa herë që poston imazhe e video të ndryshme në rrjetet sociale. Fjala është për modeluesen Oriola Marashi, e cila po vazhdon të jetë personazh mjaft i komentuar në faqet rozë. Artistja, e cila numëron ndjekës të


shumtë në rrjetet sociale, nuk heziton të publikojë postime të ndryshme duke mos munguar as pozat provokuese në koleksionin e saj. E tillë shfaqet edhe në imazhet e fundit që ka ndarë në "Instagram" teksa duket në formë të mrekullueshme.

Zidane vazhdon ta shijojë titullin e La Ligës, por tani nga pushimet luksoze



Zinedine Zidane mund të thuhet se e ka merituar një pushim të artë pasi e ka ndihmuar Real Madridin që të fitonte La Ligën në edicionin që lamë pas. Trajneri francez arriti që

ta fitojë garën ndaj Barcelonës për t'i drejtuar Los Blancost drejt triumfit në ligën spanjolle. Zidane duket se po i shijon pushimet me familjen në mënyrë që t'i mbushë bateritë për edicionin e ri.



Vjen tërheqëse në pozën e radhës nga pushimet, Beatrix Ramosaj

Këngëtarja e njohur Beatrix Ramosaj tash e disa ditë është duke shijuar pushimet në Shqipëri. Bukuroshja, e cila numëron ndjekës të shumtë në "Instagram", vazhdon të marrë vëmendje me pozat atraktive. E tillë shfaqet edhe në këtë të fundit, teksa duket në top-formë duke


eksponuar linjat trupore. Në imazhin e radhës, ku shfaqet me një palë bikini të veçanta, Ramosaj ka vënë një përshkrim domethënës. "Të vlerësojmë atë që është e bukur dhe që ia vlen në jetë", shkroi ajo. Krahas postimit, nuk munguan edhe komplimentet që mori nga fansat dhe miqtë që ka në këtë rrjet social.

Pasi e akuzuan për keqtrajtim në punë, Ellen DeGeneres largon tre producentët e emisionit

Ellen DeGeneres ka ndërmarrë masa ndaj atyre që kanë akuzuar atë për sjellje të pahijshme në punë dhe bullizëm. Prezantuesja deri më tani ka pushuar tre producentë nga puna, Ed Glavin, Kevim Leman dhe Jonathan Norman, shkruan Mirror. Variety, ditë ma parë ka raportuar se po këta të tre janë personat kryesor që e quanin atë 'tok-



sike' në vendin e punës. Lajmin për largimin e tyre ajo e ka bërë përmes një lidhje të drejtpërdrejt me telefon, për shkak të pandemisë coronavirus.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Anulohet ndeshja Lincoln - Prishtina

Ndeshja e Ligës së Evropës në mes të Lincolnit dhe Prishtinës është anuluar për shkak se tetë futbollistë të klubit nga Kosova janë konfirmuar pozitivë me Covid-19. "Loja nuk zhvillohet. Autoritetet e Gjibraltarit nuk kanë lejuar që kjo ndeshje të zhvillohet", ka thënë Avni Durmishi, zëdhënësi i FC Prishtina



konfirmuar pozitivë me Covid-19. Zëdhënësi i Prishtinës, Avni Durmishi, i ka akuzuar edhe shtetin e Kosovës dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK). "Na nuk kemi shtet, le më shëndetësi apo Institut. Prej tetë futbollistëve

pozitivë nga laboratorit i licencuar i UEFA-s në Spanjë (Gjibraltari s'ka laborator të licencuar, edhe ata i bëjnë në Spanjë), 6 prej tyre asnjëherë nuk kanë dalë pozitivë te IKShP-ja. Vetëm dy prej tyre kanë dalë njëherë pozitivë, pastaj negativë",

ka deklaruar Durmishi. Futbollistët që kanë rezultuar pozitivë në skuadrën e Prishtinës janë: Armend Thaqi, Lorik Boshnjaku, Muharrem Jashari, Diar Miftaraj, Alban Muqiqi, Eglant Haxho, Leotrim Bekteshi dhe Besnik Krasniqi.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ndeshja në mes të Prishtinës dhe Lincolnit, e paraparë që të zhvillohet të martën nga ora 18:00 në kuadër të ndeshjeve parakualifikuese të Ligës së Evropës, është anuluar. Lajmin e ka dhënë zëdhënësi i FC Prishtina, Avni Durmishi. Ky i fundit ka thënë se autoritetet e Gjibraltarit nuk kanë lejuar zhvillimin e kësaj ndeshje. "Loja nuk zhvillohet. Autoritetet e Gjibraltarit nuk kanë lejuar që kjo ndeshje të zhvillohet. Skuadra edhe ashtu ka pasur të

kthehet menjëherë pas ndeshjes në Kosovë. UEFA nuk ka dhënë vendim. Në mundësinë e saj është që brenda tri ditësh ta detyrojë Lincolnin ta dërgojë ndeshjen në njërin prej katër shteteve neutrale që kanë pranuar të jenë organizatorë të ndeshjeve të këtyre rasteve, si Hungaria, Polonia, Greqia dhe Qipro. Ose do të marr vendimin si për Dritën", ka thënë Durmishi.

Deri te vendimi i anulimit të kësaj ndeshje ka ardhur si pasojë e rasteve të konfirmuara pozitive nga skuadra e Prishtinës. Tetë futbollistë "bardhekalër" janë

Llapi përforcohet me dy futbollistë dhe një fizioterapeut

Skuadra e Llapit në edicionin e ri ka ambicie të mëdha, pasi në këtë afat kalimtar është duke transferuar futbollistë cilësorë. Të fundit që kanë zbankuar në Podujevë janë Liridon Leci dhe Alban Ramadani, kurse klubit të Llapit i është bashkuar edhe një ndër fizioterapeutët më të mirë në Kosovë, Admirim Krasniqi



mesfushori me përvojë të madhe në futbollin evropian, Alban Ramadani. "Kemi arritur marrëveshje njëvjeçare me mundësi të vazhdimit edhe për një vit me mesfushorin defanziv, Alban Ramadani", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapit.

25-vjeçari ka lindur në Gjenevë të Zvicrës, kurse pjesën më të madhe të karrierës e ka kaluar në ekipet zvicerane si Servette FC U21, FC Stade Nyonnais, FC Chiasso, FC United Zurich, SC YF Juventus, Etoile Carouge si dhe në Itali te skuadrat Calcio

Padova, Pordenone Calcio dhe SS Maceratese 1922.

Klubit të Llapit i është bashkuar edhe një ndër fizioterapeutët më të mirë në Kosovë, Admirim Krasniqi. Admirimi është i diplomuar në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit - Degën e Fizioterapisë - të Universitetit të Prishtinës. Ai ka punuar fizioterapeut në Përfaqësuesen "A" të Kosovës në basketboll, në KB Golden Eagle Ylli, KB Ponte Prizreni. Po ashtu, ishte fizioterapeut i rregullt me skuadrën U19 të Llapit në edicionin e kaluar. "Gjithsesi se kujdesi mjekësor është një ndër pikat kyçe të futbollistëve e ne jemi përkujdesur që në klub ta kemi Admirimin, i cili do të jetë në shërbim të futbollistëve në çdo kohë", thuhet në njoftimin e Llapit.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Skuadra e Llapit ka vazhduar përforcimet për edicionin e ri të futbollit 2020/2021. Të hënën në mbremje skuadrën e Tahir Batatinës e ka përforcuar mbrojtësi me përvojë të madhe, Liridon Leci. Ish-futbollisti i Dritës ka nënshkruar kontratë me klubin që drejtohet nga Tahir Batatina

për një vit. "Liridon Leci është bërë pjesë e KF Llapit. Mbrojtësi i krahut të majtë, kampion në edicionin që lamë pas me FC Dritën, ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin tonë. Leci ka përvojë të madhe në futbollin e Kosovës dhe në atë ndërkombëtar, andaj vjen si një përforsim me vlera për KF Llapin", thuhet në njoftimin e Llapit.

Të martën në stadiumin "Zahir Pajaziti" ka "aterruar"

FC Drita konfirmon largimin e katër futbollistëve

GJILAN, 18 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, ka konfirmuar se nga skuadra janë larguar katër futbollistë. Bëhet fjalë për Bunjamin Shabanin, Darko Tofiloskin, Liridon Lecin dhe Lirim Mema. "Lojtarëve si

Darko Tofiloski dhe Liridon Leci iu ka skaduar kontrata me klubin, kurse Bunjamin Shabani dhe Lirim Mema, edhe pse kishin kontratë edhe për një vit tjetër, me marrëveshje të dyanshme jemi pajtuar që t'i ndajmë rrugët,

ndoshta edhe për shkak të hapësirës së vogël që kishin në ndeshje. Ne si klub i falënderojmë shumë për kontributin e dhënë dhe u dëshirojmë shumë suksese në vazhdim të karrierës së tyre", thuhet në njoftimin e Dritës.



Besa transferon hendbollistin me të mirë grek

PEJË, 18 GUSHT - Kampionia e Kosovës në hendboll, Besa Famgas është përforcuar me hendbollistin me të mirë të Greqisë, Charalampos Mallios. "Hendbollisti më i mirë i Greqisë, Charalampos Mallios, është hendbollist i

ri i klubit tonë. Mallios sjell në skuadër përvojën e gjatë dhe shumë të suksesshme. Prej tij presim kontribut të madh për të bërë hapa para në skenën evropiane. Natyrisht edhe për të vazhduar dominimin në skenën

vendore. Mallios ka bërë karrierë të suksesshme në Greqi, Gjermani e Turqi. Tani është pjesë e Besa Famgas", thuhet në njoftimin e skuadrës pejane. Mallios ka shumë paraqitje edhe për Greqinë. Ai është

bartës i lojës së saj, kurse në njërin prej fitoreve më të mëdha të Greqisë, ndaj Maqedonisë dy vite më parë, lojtari ynë i ri ishte i pandalshëm. Kishte shënuar plot nëntë gola, më shumë se legjenda Kiril Lazarov.



FBK-ja përkrah kampanjën 'Her World, Her Rules'

PRISHTINË, 18 GUSHT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) përkrah kampanjën e FIBA Europe, "Her World, Her Rules". Drejtuesit më të lartë të FBK-së me anë të një fushate do ta shprehin përkrahjen për këtë kampanjë, që është shumë e rëndësishme për basketbollin e Kosovës, veçanërisht të femrave.

Në kuadër të kësaj fushate, drejtuesit e FBK-së, trajnerët dhe basketbollistët e Kosovës do të tregojnë se e përkrahin kampanjën "Her World, Her Rules" dhe ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të kontribuar në zhvillimin e basketbollit të femrave në Kosovë.

Drejtori i Përfaqësuesve të Kosovës, Granit Rugova, ka treguar përkrahjen e tij për këtë kampanjë, derisa në ditët në vazhdim fushata do të vazhdohet edhe nga drejtuesit e FBK-së, trajnerët dhe basketbollistët. "Her World, Her Rules" është një projekt unik dhe fushatë në mediat sociale, e udhëhequr nga FIBA Europe që ka për qëllim ta promovojë



basketbollin e femrave dhe vajzave nëpër Evropë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që realizohen në partneritet me Federatat Nacionale. "Federata e Basketbollit e Kosovës është pjesë e projektit FIBA Europe Girls' Program tash e dy vjet dhe është duke e implementuar me mjaft sukses këtë projekt, ku FIBA Evropa, pas evaluimit të vitit të parë të projektit të FBK-së, ka vendosur që ta vazhdojë mbështetjen edhe për një vit tjetër për FBK-në, e cila ka

arritur ta risë numrin e vajzave të reja që e praktikojnë basketbollin, njëkohësisht duke e rritur edhe numrin e klubeve të femrave. Federata e Basketbollit është e vendosur që të punojë në masivizimin e basketbollit femëror dhe mbështetja nga FIBA Evropa nëpërmjet projekteve të tilla si FIBA Europe Girls Program dhe kampanja 'Her World, Her Rules' është rruga e duhur për të arritur këtë qëllim", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Toronto nuk zhgënjën, Clippersat triumfojnë ndaj Dallasit

ORLANDO, 18 GUSHT - NBA ka shkuar në fazën më interesante të sezonit, atë të "play-off"-it, ku edhe janë zhvilluar katër përballjet e para tashmë. Kështu kampionët në fuqi, kanadezët e Toronto Raptorsit e nisën mjaft mirë, pasi fituan ndeshjen e parë ndaj Brooklyn Netsit me rezultatin e thellë 134-110. Në "AdventHealth" të Orlandos kanadezët nuk e diskutuan për asnjë çast fitoren, pasi dominuan 3 nga 4 fraksionet e lojës, ndërsa Nets bënë shumë pak për ta shmangur humbjen apo për të shpresuar në një përmbyesje në sfidat e ardhshme. Në arenën tjetër të Orlandos "HP Field House" u zhvillua një përballje mjaft spektakolare mes Denver Nuggetsit dhe Utah Jazzit, ku vendasit ia dolën të çojnë në favor të tyre ndeshjen e parë, vetëm pas luajtjes së kohës shtesë. Koha e rregullt përfundoi barazim 115-115, ndërsa në shtesë Utah Jazzi u dorëzua duke humbur me shifrat 20-10



dhe gjithë ndeshjen 135-125, por edhe duke zhvlerësuar një paraqitje mbresëlënëse të Donovan Mitchelit, i cili shënoi 57 pikë, rikuperoi 9 topa dhe dha 7 asistime. Sloveni Luka Donçiq dhuroi paraqitje mjaft të mirë në sfidën "play-off" mes Los Angelos Clippersit dhe Dallas Mavericksit, duke regjistruar 42 pikë, 7 rikuperime dhe 9 asistime, por që nuk i mjaftuan të tijve për ta shmangur humbjen. Skuadra nga Los Angelesi

menaxhoi më mirë lojën dhe arriti të fitojë me shifrat 118-110, ndërsa fati i ndeshjes u vendos në fraksionin e tretë ku Clippersi përfitoi nga një "black-out" i Mavericksit dhe fitoi me shifrat 21-13.

Jayson Tatum dhe Jaylen Brown ishin protagonistë për Bostonin në përballjen e parë "play-off" përballë Philadelphia 76ers, pasi të dy bashkë shënuan 61 pikë, rikuperuan 19 topa dhe dhanë 5 asistime, duke i dhënë fitoren Celticsit me shifrat 109-101.

SHKURT

Ujkani vazhdon bashkëpunimin me Torinon

Portieri i Kosovës në futboll, Samir Ujkani, e ka vazhduar bashkëpunimin me skuadrën e Torinos edhe për një vit tjetër. Klubi italian në faqen zyrtare ka njoftuar se Ujkani do të jetë pjesë e saj deri në qershor të vitit 2021. Është raportuar se ka pranuar të qëndrojë si portier i dytë edhe për një vit te torinezët. Portieri 32-vjeçar te Torino u transferua në shtator të vitit të kaluar dhe vetëm në fund të edicionit që përfundoi javë më parë luajti një ndeshje.

Silva 'driblon' Lazion, transferohet te Sociedadadi

Pak orë pasi u përshëndet me skuadrën e Manchester City, David Silva është zyrtarizuar në La Liga. Mesfushori spanjoll ka nënshkruar me skuadrën e Real Sociedadit. Silva ishte afër marrëveshjes me Lazion, por duket se gjithçka ka ndryshuar në minutat e fundit. Silva ka nënshkruar marrëveshje të vlefshme deri në vitin 2022. Ai kaloi te skuadra e Sociedadit si transferim i lirë, pasi kontrata me Man City ishte e skaduar. Transferimi i Silvas te Sociedadadi vjen si befasi, pasi lojtari veçse kishte marrëveshje personale me Lazion për kontratë trivjeçare, madje thuhet se ishin caktuar edhe testet mjekësore.

Hamiltoni: Ky është çelësi i sukseseve të mia

Lewis Hamiltoni zhvilloi një tjetër garë të shkëlqyer në Barcelonë fundjavën e kaluar, ku korri fitoren e radhës në Botërorin 2020 të Formula 1. Ai e nisi garën nga "pole position" dhe nuk e dorëzoi kreun në asnjë çast, duke kryesuar i shkëputur edhe renditjen e përgjithshme. "Ishte një fundjavë e përkryer dhe falënderoj skuadrën për makinën që më ka vënë në dispozicion. Ishte një garë ku nuk bëmë asnjë gabim dhe fitorja ishte e merituar", ka thënë piloti britanik i Mercedesit. Duke folur pikërisht për këtë paraqitje të mirë në vitet e fundit, Hamiltoni ka deklaruar: "Çelësi i sukseseve të mia është se në garë përpiqem të mos bëj asnjë gabim, ose të bëj sa më pak gabime. Për këtë arsye përgatitem shumë psikologjikisht, që të mos shpërqendrohem, sidomos në startin e garës, ku dhe mundësia për të gabuar është më e madhe".

Katër futbollistë pozitivë me Covid-19, shtyhet nisja e Ligës 1

Ndeshja hapëse e kampionatit francez për sezonin 2020-2021 mes Marseille dhe Sain Etienne është shtyrë pasi Olympique de Marseille ka njoftuar se kishin konfirmuar edhe tri raste të tjera me Covid-19, duke e çuar numrin në katër të të infektuarve. E programuar për të premtën e 19 gushtit, ndeshja do të zhvillohet në një tjetër moment, pasi katër lojtarët janë izoluar dhe pjesa tjetër do t'i vijojë kontrollet për Covid-19. Në Francë të gjitha skuadrat po testohen për sezonin e ri, ndërsa deri në këto çaste vetëm Marseille është prekur nga koronavirusi.

Lukaku: Interi është këtu për ta fituar Ligën e Evropës

Romelu Lukaku e ka paralajmëruar Sevilën se Interi është i vendosur për ta fituar Ligën e Evropës, pas triumfit tejet bindës të gjigantit italian 5-0 kundër Shakhtar Donetskut në gjysmëfinale. Sulmuesi belg i shënoi dy gola në fitoren e thellë të Interit të hënën në Dusseldorf, duke i ndihmuar ta arrijë finalen e parë evropiane pas plot një dekade. Në finalen e së premtes, Interi do të përballet me Sevilën, e cila e mundi Manchester Unitedin në gjysmëfinale. "Ekipi po luan shumë mirë. Të gjithë po përpiqen ta bëjnë më të mirën. Ne kemi punuar vërtet shumë në kampin stërvitor. Ka qenë e vështirë, por tani po i shohim rezultatet e punës së zellshme", ka thënë Lukaku. "Çdo gjë po shkon mirë... ne jemi këtu për të fituar, edhe pse ekipi kundër të cilit do të luajmë është favoriti", ka shtuar Lukaku.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit-
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine - Ministry of Economy and Environment

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë, (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 25/ 14 Korrik 2016, për emërim të kandidatit për Kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, shpallë:

KONKURS

Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE)

Detyrat kryesore të Kryesuesit të Bordit të Rregullatorit:

Përveç përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Kryesuesi i Bordit të Rregullatorit në koordinim me Bordin e Rregullatorit:

- miraton politikat rregullative dhe operacionale të Rregullatorit;
- organizon dhe mbikëqyrë punën e Rregullatorit;
- mbikëqyrë zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Rregullatorit dhe
- miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- organizon procedurat e rekrutimit dhe mbikëqyrë punën e personelit të punësuar
- nga Rregullatorit;
- miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e
- Rregullatorit;
- harton dhe miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët dhe personelin e
- Rregullatorit;
- harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë;
- përfaqëson Rregullatorin para palëve të treta;
- vepron në emër të Bordit të Rregullatorit dhe e përfaqëson atë në të gjitha procedurat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- përcakton Axhendën e mbledhjeve të Bordit;
- kryeson mbledhjet e Bordit
- bashkëpunon me organizma të ndryshëm ndërkombëtarë që veprojnë në sektorin e energjisë ;
- raporton një herë në vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Kandidati për kryesues të Bordit duhet të ketë:

- Diplomë universitare në fushën teknike, të ekonomisë apo të drejtësisë nga një institucion i akredituar i arsimit të lartë;
- Së paku dhjetë (10) vjet përvojë pune në sektorin e energjisë, prej tyre pesë (5) vjet duhet t'i ketë përvojë në menaxhimin në fushën e energjisë;
- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, me vendbanim të përhershëm në Kosovë; si dhe,
- njohuri të gjuhës angleze në të folur, të shkruar si përparësi.

KUSHTET

Kandidatët që konkurrojnë për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji duhet:

1. Të mos kenë dosje të hapur të hetimeve apo dosje të mëhershme të dënimit për veprë penale apo të aktiviteteve që mund të vënë në dyshim sinqeritetin, integritetin apo kompetencën e tij.

Kryesuesit të Bordit gjatë mandatit të tij në këtë pozitë nuk i lejohet:

2. Të jetë zyrtar qeveritar;
3. Të jetë pjesë e strukturave të një partie politike;
4. Të jetë vetë, ta ketë bashkëshortin/en apo ndonjë të afërm të

familjes së ngushtë në cilësinë e aksionarit, partnerit, pronarit ose menaxherit në një ndërmarrje të energjisë që i nënshtrohet këtij Ligji, apo në një ndërmarrje vartëse apo në një filial të një ndërmarrjeje të energjisë;

5. Të kryejë çfarëdo pune për ndonjë ndërmarrje të energjisë që i nënshtrohet këtij Ligji, apo për ndonjë ndërmarrje vartëse, apo për ndonjë filial të një ndërmarrjeje të energjisë;

6. Të mbajë një pozitë tjetër në kuadër të Rregullatorit;

7. Të kryejë një aktivitet tjetër që mund të rezultojë në konflikt interesi sipas Kodit të Etikës Profesionale të hartuar dhe të miratuar nga Rregullatori, apo sipas ligjeve përkatëse.

AFTËSITË PERSONALE TË KËRKUARA

- Udhëheqje
- Pune ekipore
- Bashkëpunim efektiv me palët e interesit;
- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURRIMIT

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit siguron që procedurat e përzgjedhjes të jenë të hapura, ofron konkurrencë jo-diskriminuese, objektive dhe transparente, duke u bazuar në një grup

kualifikimesh dhe aftësish të përcaktuar më parë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e sektorit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë duhet të dorëzojnë këto dokumente (**Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit**):

- Kërkesa për punësim - mund ta gjeni në Web faqen .
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Listën Kontrolluese të plotësuar dhe nënshkruar duke deklaruar cilat prej kriterëve themelore dhe të dëshirueshme aplikanti i plotëson. Kjo listë mund të shkarkohet duke përdorur linkun .
- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivimin duke ofruar një shpjegim të qartë se si përvoja dhe aftësitë e juaja (aplikantit) përputhen me kërkesat detyrës.
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës për të gjitha pozitat përkatëse)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Deklarata nën betim mund të shkarkohet në Ueb faqen e MEA-së.

Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe titulli i pozitës në të cilën aplikon kandidati) dhe të dorëzohen në MEA, zyra nr. 102 (Arkiva), Adresa Rruga "Nena Tereze" Nr.36 Prishtinë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes Nr. kontaktues 038/ 200 21524.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkurrimit nga data 19.08.2020 deri më datë 18.09.2020, deri në orën 16:00. Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit.

Për vëmendjen tuaj: Ky proces rekrutimi do të monitorohet nga përfaqësues të Projektit Britanik për Emërim në Pozita të Larta Drejtuese. Kandidatët njoftohen që emrat, rezultatet dhe kualifikimi i kandidatëve me rangimin më të lartë në këtë garë si të emërueshëm, do të publikohen në ueb faqen e projektit dhe që me të aplikuar për këtë pozitë do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi për publikim.

Gjithashtu, do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi që partnerët zbatues nga distanca të kenë qasje dhe përkohësisht, në mënyrë të sigurt të ruajnë informata lidhur me vlerësimin e aplikimit dhe performancës së kandidatëve. Informatat do të fshihen në mënyrë të përhershme pasi që ketë përfunduar vlerësimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit-
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine -Ministry of Economy and Environment

Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine na osnovu člana 5. stav 2 Zakona br. 05/L-084 o Energetskom Regulatoru, (Službeni List Republike Kosovo Br. 25/14 jul 2016 godine, radi imenovanja kandidata za Predsedavajućeg Odbora Regulatornog ureda za energiju, raspisuje:

KONKURS

Predsednik Odbora Regulatornog ureda za energiju

Glavni zadaci predsedavajućeg odbora regulatora:

Pored odgovornosti utvrđenih Zakonom o energetskom regulatoru, Predsednik Odbora Regulatora u sardnji sa Odborom Regulatora:

- usvaja regulatorne i operativne politike Regulatora;
- organizuje i nadzire rad Regulatora;
- nadzire izvršenje budžeta i finansijsko upravljanje Regulatora i usvaja njegove finansijske izveštaje i izjave;
- organizuje procedure za regrutaciju i nadzire rad zaposlenog osoblja Regulatora;
- usvaja nivo naknade i druge uslove zapošljavanja za zaposlene Regulatora;
- izrađuje i usvaja Kodeks profesionalne etike za članove i osoblje Regulatora;
- izrađuje i usvaja podzakonske akte neophodne za sprovođenje ovog zakona.
- predstavlja Regulatora pred trecim licima;
- deluje u ime Regulatornog odbora i zastupa ga u svim relevantnim procedurama u skladu sa važećim zakonima;
- utvrđuje agendu sastanaka odbora;
- predsedava sastancima odbora
- saraduje sa različitim međunarodnim organizacijama koje posluju u energetskom sektoru
- jednom godišnje izveštava Skupštini Republike Kosova.

PROFESIONALNE KVALIFIKACIJE I PODOBNOST

Kandidat za predsednika Odbora Regulatornog ureda treba:

- Da ima univerzitetsku diplomu u tehničkoj oblasti, ekonomije ili prava od jedne akreditovane institucije visokog obrazovanja;
- Da ima najmanje deset (10) godina radnog iskustva u energetskom sektoru, od kojih pet godina treba imati iskustvo u menadžiranju u oblasti energije;
- Biti državljanin Republike Kosova, sa stalnim boravkom na Kosovu; kao i,
- Poznavanje engleskog jezika, u govoru, pisanju predstavlja prednost.

USLOVI

Kandidati koji konkurišu za Predsednika Odborom Regulatornog ureda za energiju moraju ispunjavati sledeće uslove:

1. Da nemaju otvoreni dosije istrage ili raniji dosije osude za krivično delo ili aktivnosti koje bi mogle dovesti u sumnju njegovu iskrenost, integritet ili kompetentnost;

Predsednik u Odbora za vreme njegovog mandata na ovoj poziciji nije dozvoljeno:

2. Da bude zvaničnik Vlade;
3. Da bude deo struktura političke stranke;
4. da on sam ili njegov/njen bračni drug ili član uže porodice ima svojstvo akcionara, partnera, vlasnika ili menadžera u nekom energetskom

preduzeću koje podleže ovom zakonu ili nekom zavisnom preduzeću ili filijali energetskog preduzeća;

5. Da obavlja bilo kakav posao za neko energetsko preduzeće koje podleže ovom zakonu ili za neko zavisno preduzeće ili neku filijalu energetskog preduzeća;

6. Da drži drugu poziciju u okviru Regulatora;

7. Da obavlja druge aktivnosti koje mogu dovesti do sukoba interesa u skladu sa Kodeksom profesionalne etike, izrađenim i usvojenim od strane Regulatora ili u skladu sa relevantnim zakonima.

POTREBNE LIČNE VEŠTINE

- Upravljanje
- Timski rad
- Efikasnu saradnju sa zainteresovanim stranama
- Strateško razmišljanje
- Orijentisan/a na rezultate
- Odlučivanje
- Sposobnost uticaja
- Jasna doslednost, koncizna komunikacija
- Integritet
- Samosvest
- Kreativno razmišljanje

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDURAMA KONKURISANJA

Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svih građana Kosova te ljubazno dočekujemo prijave svih zajednica na Kosovu. Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine osigurava otvorene procedure izbora, nudi nediskriminatornu konkurenciju, objektivnu i transparentnu konkurenciju, zasnovanu na skupu kvalifikacija i gore definisanih sposobnosti.

Nevećinske zajednice imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima

javnog sektora prema važećem zakonodavstvu.

Kandidati za Predsednika Odbora Regulatornog ureda za energiju moraju dostaviti sledeće dokumente (**propust da to urade ima za posledicu odbijanje prijave**):

- Zahtev za zapošljavanje - mogu se naci na veb sajtu .
- Izjavu pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku dostavljanja dokumentacije)
- Kompletan spisak-popunjen i potpisan uz navodjenje koje od osnovnih i poželjnih kriterijama ispunjava kandidat. Ovaj spisak se može preuzeti upotrebom sledećeg linka .
- CV koji pruža primere dostignuća u radu
- Motivaciono pismo koje obezbeđuje jasno objašnjenje kako iskustvo i veštine podnosioca odgovaraju zahtevima obaveza.
- Dokumentaciju predviđenu u uslovima zapošljavanja (dokazi o profesionalnim kvalifikacijama, radnom iskustvu za sve relevantne pozicije)
- Uverenje (dokaz) koje dokazuje da nije pod istragom
- Državljanin Kosova (kopija pasoša ili lične karte).

Podnosilac prijave, prilikom podnošenja prijave, mora lično da popuni izjavu pod zakletvom, u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove profesionalne kvalifikacije, nezavisnosti i podobnosti. Izjava pod zakletvom se može preuzeti na sajtu MEŽS. Svako lažno predstavljanje, bilo namerno ili usled nemara, ili materijalna razlika od informacija datih u gore navedenoj izjavi dovodi do momentalne diskvalifikacije.

Dokumentacija se mora nalaziti u zatvorenoj koverti (sa ispisanim imenom i prezimenom i nazivom pozicije za koju kandidat podnosi prijavu) i ista se predaje u MEŽS, kancelarija br.102 (Arhiva), na adresi: Ulica "Majke Tereze " br. 36 Priština.

Dostavljena dokumentacija se neće vraćati. Tokom intervjua se mogu tražiti originali. Dodatne informacije možete saznati putem kontakt telefona 038/ 200 21524.

Kontaktiraće se samo kandidati izabrani za intervju.

Rok konkursa od dana 19.08.2020 do dana 18.09. 2020, do 16:00 sati.

Konkurs je otvoren 30 dana, od dana objavljivanja.

Za vašu pažnju: Ovaj proces regrutacije ce pratiti predstavnici Britanskog projekta za imenovanja viših rukovodećih pozicija. Kandidati se obavestavaju da ce imena, rezultati i kvalifikacije kandidata sa najvišim rangom na ovom takmičenju biti objavljeni na veb stranici projekta i apliciranjem na ovu poziciju smatrat ce se da je dato odobrenje za objavljivanje.

Takođe ce se razmotriti mogućnost da je saglasnost data implementacionim partnerima za pristup u daljini i privremeno, sigurno čuvanje informacija u vezi sa ocenom i performansama aplikacija kandidata. Informacije ce biti trajno izbrisane nakon završetka evaluacije.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit
Nr. 01-464/01-32917, dt. 17.08., 2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, nenit 97 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.400/01-28798, të datës 30.07.2020, Vendimit Nr.020-545/6, të datës 14.08.2020 të MPL-së, për ligjshmërinë e vendimit Nr.400/01-28798, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

I.

Miratohet kërkesa e subjektit kërkues, Komunës së Drenasit/Glllogocit për shpronësimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.-P-70315056-120, me sipërfaqe prej 1413m², në pronësi të Sadri Hasan Muqollit nga Pokleku, zona Kadastrale Poklek. Qëllimi për të cilin shpronësohet kjo pjesë e parcelës, ka të bëjë me zgjerimin, modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të Stadionit të qytetit të Drenasit "Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri, me kompensimin e pjesës së shpronësuar të pronarit, sipas tabelës së bashkangjitur me këtë vendim.

II.

Pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohet pronari i pjesës e cila do të shpronësohet, e që brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit i njëjti do të shpallet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

III.

Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronarë ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit/Glllogocit.

V.

Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes së tij në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

Tu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorive përkatëse;
- Arkivit të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

PARAQITJA TABELARE E PARCELËS PËR SHPRONSIM

Z.K.K. Drenas						Z.K. POKLEK						Z.K.K. Drenas						Z.K. POKLEK					
Gjendja e vjetër						Gjendja e re						Gjendja e re						Gjendja e re					
Nr.	Pronari	Nr. parcelës	Kultura-Klasa	Sipërfaqja m ²	Lloji i ndryshimit dokumenti në të cilin bazohet ndryshimi	Nr.	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura-Klasa	Sipërfaqja e mbetur m ²	Sipërfaqja për tu shpronësuar m ²	Verejtje	Nr.	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura-Klasa	Sipërfaqja e mbetur m ²	Sipërfaqja për tu shpronësuar m ²	Verejtje				
1						7							7										
1	Sadri Hasan Muqolli	120-0	arë kl.2,3,4,5	3725		24	Komuna Drenas	120	arë kl.2,3,4,5	2312	1413												
TOTAL:						TOTAL:						TOTAL:											

Gjeodet.: Fadi



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR ZYRE PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informatat mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Referenca lidhur me furnizimin me material shpenzues.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garancionin dhe cilësinë e furnizimeve.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të mbyllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejës, pn. (magjistralla Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2020 nga ora 14:00-15:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.org



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME DERIVATE TË NAFTËS DHE BENZINËS PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informatat mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Referenca lidhur me furnizimin me derivate.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garancionin dhe cilësinë e furnizimeve.
- Cilësia e furnizimit të derivateve të jetë në harmoni me Udhëzimin Administrativ 01/2017- MTI

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të mbyllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejës, pn. (magjistralla Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2020 nga ora 10:00-11:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.org



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr. 11/

Më: 18.08.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2020/2021

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë	Matematikë	Zëvendësim i lehonisë	1	20
2	SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë me 14 orë mësimore dhe SHFMU" Ismail Qemali" në Bellanice me 4 orë mësimore të lëndës së TIK-ut	TIK	Zëvendësim i lehonisë	1	18

I. Aplikacioni i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letënjohje ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Certifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr 04/L-032 dhe , Ligji Nr. 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së matematikës kërkohet kualifikimet: Niveli master arsimor-**Fakulteti i Edukimit (300) ECTS; Sistemi katërvjeçar; Beçelor (katërvjeçar 240 ECTS)** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të TIK-ut kërkohet kualifikimet: **Programi /Dega Teknologji-Informatikë; Niveli Master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS) Sistemi Katërvjeçar; Bachelor katërvjeçar 240 ECTS);** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruar pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe testit me gojë sipas nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunitetit të Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **18.08.2020 deri më datën: 02.09.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunitetit të Malishevës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Drilon Shkreta shpalle te pavlefshme Diplomën e Sh.M.L. "Dardania" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783